

NANDO ELMO

**NJ' E PRËMT'E VOGËL
dhe të tjerë rrëfime**



KALUQI

Copertina di Cesare Elmo

*Stampato in proprio
Rivarolo Canavese 2017*

NJ' E PRËMT'E VOGËL

U ngre njize somenat për të shoshnej miell. Ka të bënj kuleçet e Pashkëvet. Zjarri do çivosur: “Ec mirr di gobaçe¹”. Më² vjen kjo vuxhë ka thellmitë e shpirtit. Më merr si një dridhim që më shkundin ka gjumi që të zë prëz zjarrit. Prusha është e bënëti hi. Kam të zgjofem ka përtesja prapa së cilës jam’e fshefinj një ndiemje armike kundër gjithë shurbiset që më rrethojin. E megjithatë kët kthim e kisha dashur me gjithë zëmër. Mund t’jet se është tëtimi. Mund t’jet se është mot’i lig: bie shi, borë e breshir. Mungim’i dritës më helmon. Po mund t’jet se u rreshkta.

Vrenj ka dritësorja ka an’e Sybarit. Re të rënda mbllijin orizondin, nxin ka mesimvria³.

Nani u ngre edhe era. Fryn levandina e shtie shiun me forcë kundër vitrjatat. Kanalletat madhësojin llavinat me ujët që mburon ture

¹ *Legna da ardere; un quarto di tronco.*

² È necessario ricordare che questo “io narrante” (io? Cos’è questa *merde* metafisica? Questa presunzione d’identità stabile, come fossimo, nella stabilità, solo e soltanto delle finzioni e delle funzioni burocratiche?) è una finzione retorica, una metafora vuota? E che luoghi, nomi e personaggi sono arbitrariamente presi da luoghi e persone casualmente reali?

³ *Sud, mezzogiorno, meridione.* Espressione, devo dire la verità, che udivo solo da mia nonna. Oggi nessuno saprebbe dire di che si tratti. Forse mia nonna l’aveva appresa da suo fratello Nicola Aronne che era stato adetto consolero a Cipro. Egli parlava correntemente il greco antico e il moderno. Io ho considerato sempre “*mesimvria*” come termine pienamente arberisco-acquaformositano, ereditato dalla provenienza “tebana”, da *Kaparelli Thivon*, dei nostri antenati.

gurgulosur. Ka çimineret ngrëfet fumata ç'era shprishin ture e spavur në një moment.

Do' t'isha fumatë. Do të spavështa në një moment.

E më zë ankthi: “Kush më suall më katund?”.

Kush më suall e di: një çë qellinj me mua me psim, çë ngë dua të ruanj ndër sy.

U bëra i huaj, i xheshur ka gjithsej. Nge kam kënaqësi as edhé për të ngrënat çë mëma ë e përgaton. Bora nga oreks.

Kurmi. Kurmi ë ket njetër vend. I rëndë ngë më përgjegjet.

Me përshekjin mejtime të huaj për ket' jetë. Thom se mjeshtria ime është të bëfem nga mot i huaj. Ika i huaj ka dheu im, vajta ket një dhe i huaj tek u banonj i huaj. E më i huaj i vetëhes sime më bëri moti. Pse nani më mëshon ki i huaj? Thon se liria është barra më i rëndë. Të lë xhakarun pa mbrojsë.

Vuxh'e mëmës bën'e zgjofem ka angëthet: “Çë do të hash sot? Vura më zjarr di qiçëra. Do bën di shtridëla? Ësht e prëmtja sot ngë mund të kamaromi”.

Ndienj këto fjalë të moçme, t'huaja. Çë kam kifari me ato? më qelljin dhunë. Bënj një ftigë të madhe t'i përgjegjem, sikur se me fjalët do t'i lidhem njëj gjellje ka ku desh' t'ikja, njëj barrje ka e cila desh' të skrakofsha.

Nani gjimon. Bie breshir, trukulim'i tij na bën më të qetëm. E si do t'jetë kam t'i jap fjalë kësaj gruaje çë më lindi.

Më lindi.

Një angëthë. Një ndjenjë ftesje. Çë ftesë? Se u leva. U leva te ki katund, ket ki kurm ç'u bë i rënd. Kush caktoj këtë fat?

“Ng'je vete më qishë sot? Sa më te rrish prëzë policës⁴, pse ngë vete më qishë?”

Harroj se ng'jam surbes'i saj. Se jam i huaj. Sesì i huaj harrova shumë shurbise, pikërisht sesa të bëfsha i huaj. Sa shurbise harrova?

Vreshtat.

⁴ *La parte più riposta del focolare dove si raccoglie la cenere.*

Atjè hinej e hollë e e likshtë Jurendina. Kish sy çë më shpojin e u djalosh i turpëm ulënja timët. Fshefsha ndë mes t'udrivet o prapa nj'ulli për t'e vrenja i babartur me zëmrin e trubulluar.

“Pse fshefe? Mos je bën shurbise të liga?” thoj ajo ture qeshur.

Qeshjet e saj të paturpme, shpojn ngamot qetesin e farnitavet. Tandonej gjumin tim. Ëndra çë turpja më ndalon të rrëfienj. Kur u bëra trim, me të parin mjekër, qe ajo e para grua. “Çë do ti bir? Pse dridhe i tërë?”. Diti ajo atë çë kish të bënej, pa se u t'i lypnja gjë. Kisha dashur se kurmi im kish t'u kish bën një me të saj, i dejim ka era e egër e saj. Donja atë mortje. Ajo mortje e vogël, si e thon Françisët, ka vesin se nëng duron. E na gjellomi ket një vapkësi e paduruashme, ket errësi'e dishirimëvet. Sidomos venja i lezë. Jurendina më kish vën penda hjesije e këndonja si gjel lëmi.

*** **

Trokëllisjin ka dera. Hin një grua gjith'e fashquar ket një pan'i rëndë e picirr. Veshin stolit'e moçme. Ka pani i duken vet dy sytë.

“Ng'e ke një lumbrele?” i thot mëma.

“Ngë më bën gjë shiu mua. Sa shira mora kalosh, ndër vreshtat e anamesa ullinjëvet, o e harrove?”. Nxier panin ka kriet. E njof. Ësht Jurendina, çë vjen e pi një qelq verë nga dita ka mëma e i siell novat . U mbjak. U zgjirua. Më duket e vogël e vogël. Ish kjo ajo grua e hollë e hollë çë shkonej si fatë e bukur midhis udhrivet e më vënej turpë?

Ka sytë të kaltër si gjithë pjakat. Serqe të thellë i bejin çerin si një dhe pjotë argoma. Mos ngë dinja kush qe, mund edhe të vëlersonja këtë skulptur të motit, po shof vet dhunin e tij.

“Po kush të njif, biri im? Ti u bëre liti”. Më masin me sytë, ture djovasur litirsinë ket fixha ime. Pra ture më dhën një shtim: “I bën angora shurbiset e liga? O u shuajte. Duket se u mbjake edhe ti”. Lëshon gazin e farnitavet.

Qellin dhunë gjella. Ish thërritj'e saj, një herë, gaz'i Jurendinës.

“Ng'e bore gazin” i thom.

“Ndose kisha bjerr gazin, sa shkova u ...Po ti si rri ti? E bën angora gjelin?” e lëshon një mallkim.

Jurendina ka një të folmë të paturpme, çë mosha ng’i butsoj.

Mëma e parkalesin: “Mos thuaj skandale. Sot është e prëmtja e madhe”.

“Po u ngë bëra kurrë shurbise të liga me profesurin, mund t’ish im bir”. E më vren me sy të njomë, ujë ujë çë, ket drita e pakët çë hin ka dritësorja, i shkilqejin.

“Çë je e i bën gallandomit”. I qaset dërrasës çë mëma grien me ksistrin.

“Ka të vjen gjith kjo fuqi. Mos i rri prapa tu bilëve, se ngë të kan abullkacjun⁵” i thot.

“Jan Pashkët”

“Erdhe të bënje Paskët më katund?” më pien Jurendina.

“Mund t’jetë” i përgjegjem.

“Ngë di e i shkunde katundit, ndomos se u bëre i huaj”.

Ngë di e i skundem katundit ndomos se u bëra i huaj. Po ng’jam u i huaji. Ësht njetër çë më banon, çë do sigurië, ç’i rri i lidhur shërbiseve të cilavet ng’i marr më vesh.

*** **

Vejin ket rrazulla⁶ anagana grurit çë verdhej. Ajo përpara me një capuliq ndër krafë e ai prapa. I përgjonja prapa një mën. Kur ja rrun ket gardh’i gërshivet, ai e rrëmbej e e shtu ndë mes të kallivet. Ahirna Jurendina i ka dhën kopilerinë e saj atij trimi çë kish të bëfej i shoqi. Kur u ngre e ndreqi vestin e lesht të shpjeksur ndiejta se ka syt më zdrypëshin lotë të ngrofta.

Kur dishërova të birsha ket misht’ e saj i mejtova atë përpjekje.

Qeshi:”Kishe zili? Ç’është një grua për ju? Ahirna ishe i vogël”

Ngë di ndose kam të qeshin për lotët e atij moti.

⁵ *Obbligo, obbligazione, dovere.*

⁶ *Rasola.* Sentiero che consente il passaggio tra i seminati, tra i filari degli orti e delle vigne ecc... Ma anche solco tra i seminati per regolare l’acqua piovana.

Më priret ket kujtimi ajo figurë e drëjtë e patundshme, me lloret xheshët të ngrëjtur sa të ndreqënej lesht. E pjerrë prap ndër veshlat, me kurrizin e tendosur, prit si një drapër i ehjur orizontin mbatan gërshivet.

I vajta prapa asaj bëlicje i marr si Davidi për Bersaben. Këndova për shum mot, edhe u, një këndim i këndimevet për një Bersabë, çë kish të shoqin llargu e ngë lënej shtratin e saj të shkretë. Sot ç'është dit sumbulku i nakatostë mejtonj helmin e Koheletit: Lënësi e lënësivet. Gjithë jeta është një lënësi çë ka të na bier.

Kush qe ai djalosh i kujit i dridhej zëmëra e në një frim i thoj Bersabësë: "Më do vet mua?"

"Çë do të dish?" i përgjegjej ajo mose me mallixje. E zilia i hanej mulshitë atij Davidi pa kurorë.

E si Davidi doj të kisha qën shënjët e mëkateruam, mëkateruam e shënjët. E mund t'jetë se mëkatja piell shëjterin, se si koprea lulen. E shëjteria ish mbushja çë trasfiguron e losin vetëhen tënë ket bukuria, ture e zgjidhur ka gjithë rëndësit.

I kam këtë i dhebët kujtesi Jurendinës, jo për më gjë, po, sa më pak, për faktin se më nxuar ka helmet e njëj djalerie të turpshme.

Si bir patruni, kur ngë kisha për me bën me skollin, venja ndër dherat sa të xënja si rufet petku. I venja prapa burravet çë armojin, o bëjin argoma o tokasjin. Më pëlqenej shum kur putojin ullinjët e gjegjej eho e topris së llargu. I venja prapa gravet kur skalisjin grurt, kur vjilëjin ndër vreshtat, o mbjidhjin ullinjët.

Asi viti kish qindruar vet një ulli për me mbjedhur. Ngë kishim taksur të tjerat gra. Sosnej Jurendina të mbaronej atë ftigë.

Kur ja rrura ndë mes t'ullinjëvet e e pe mespurtek me lloret të ngrëjtur të rrënej një degë, u mbajta llargu prapa njëj lisi. Si ngamon, m'u trubulluan ndjenjët, përcillnja vakand: Jurendina, Jurendina, Jurendina. Ishim të vetëm.

Moti ish i vrëjtur, po ngë dukej se kish të zënej shiu. Në një moment u gre nj'erë e fort, gjimoj dy tri herë e zu shiu. Jurendina lëshoj një par mallkime. Kërkoj të mbllinej cakulet me ullinjët e u anangas e lagët ket kalidja. Edhe u prita ndë mes të vreshtës pa ditur çë kish'të bënja. Pra kur qeva picirr, u anangasa edhe u ket kalidhja.

Jurendina kërkonej të ternej çerin e lagët: “Çë djallin je bën këtë. Ka dollë?”

“Më than të vij’ të të ndifnja të ngrakonje gadhjurin”.

Jurendina ngë dukej se m’jip akund. Shkundnej vestat e lagta. I pikojin vetullat. Pra më ruajti si me arkanxje⁷: “Pse ngaherë çë më shef mua fshefe. Të pe prapa lisit”. Ula syt më truall si një llatrun i ciposur më të⁸.

“Mos më ke ndo një simpati për mua? Shi’ se u jam mëmë bilash”

Më ruanej si e dijtur e si e padhuruashme të kish ka u një pergjegje çë ng’e arrënej.

“Va be’, va. Ea këtu se të shutarinj lesht. Je picirr”.

Ju qasa ture u dridhur. Jurendina sa më të më ternej lesht, më shkoj dorin ndër faqet: “Pse dridhe? Çë do ti bir?”

Ahirna m’erdh një shtytje t’i kariconja lloret e lagëta e re me buzin mbë gjirin e saj. Mbjatu më përqafoj sikur ng’ish’e prit ndrishe. M’uli hundët ndër sisët.

“Oj biri im, oj biri im” më thoj ture më puthur.

Më nxuar ka helmet, o më shtu më thellë?

Dhon Fernandi, i dejim si nga dita, vej ture spjeguar “*ewige Wiederkehr*”, si thoj me shprekjen tedeske kthimin e përjetshëm e Nietzsche: “T’urtët bëjin shumë fjalë. Spjegofet kështu: Nga dita ke të hash e të pish. E ngë mund mos të hash e të pish. Nga dita do të të zër gjumi e do të zgjofesh. Nga dita të priret ki fat, të priret varesja e të njëjtit shurbes e ti ngë mund të shpëtosh ka ki fat, se si ngë shpëton ka rreth’i saj hëna. Ligje kosmologjike “*ewige Wiederkehr*” është edhe fat’i njeriut, jo vetim fiziologjik po edhe i psikologjisë. Sa të shpëtosh ka varesi’e të ngrënit nga dita do të ndrosh ushqimet e artistikisht mejton se ndron me fandasin fatin tënd i njëjtë. Illuzion’e artistëvet. Khtim’i përjetshëm priret kët dëshir’i shurbisevet të rea. Del ka një shklaveri se të hish ket njetër. Rrethi të rrëmben një tërë manerë. Ku vete liri’e njeriut, se si thon? E njëjta liri është të

⁷ Arroganza.

⁸ *I ciposur më të* : sorpreso sul fatto.

harrofesh, me një qelq verë, ose me më gjë”. Ketu kish ngrëjtur qelqin verë ç’i kish sjel e jëma sa të zënej zëmërin, si thoj ajo.

“Me shëndet djelme çë çivosni⁹ sprënxa”. Pra më kish ruajtur mua: “Ti si shpëton ka rrethi?”.

U, ç’aso ditje kisha akoma kalosh merën e egër e Jurendinës e ndër duar venja ture thithur aromin e mishit të saj, i pakujdheshshëm e i ndaluar ruajta profesorin pa ditur çë kish’ të thonja.

“Mir, mir, duket se e ke gjetur nj’illuzjon prapa se cilës do të biresh”. Dhon Fernandi më djoavasnej trutë? Pjotë turpë ula syt.

Gjithë natin mbeta prapa asaj shtypje, i bjerr, ture pritur se të prirej papani përpjekja me Jurendinën. Ki ish rrethi çë deshëronja: prirsha ka der’e Jurendinës me sprënzin se të façofej e të më thërrit mbrënda për të më parkalesnej: “karicom karicom” ture më qellur duart ket kurriz’i saj i përkult si ai i njëj maçje.

Gjegjënja dhon Fernandin me Nietzsche-n e tij: “Vet medjokrat duan se lumturia ka të rier pa tundje”. Po u ngë donja se ngë kish të tundej, donja se kish të prirej... Dreq se si thoj dhon Fernandi ture cituar të llavurin tedesck: “Sillu me një maner sa të deshirosh të priresh papa të gjellosh se si gjellove”. E u do’ të prirsha ket gjir’i Jurendinës sa të përsërinja atë të parin përpjeqje. Po nga here ish njetër shurbes. Ironi’e dhon Fernandit, kur ngrënej qelqin e i brindarnej të rinjëvet çë çivosjin sprënxat të bukura, më plagosnej. Prirej vet oreksi jo mbushja e të parës herë. Po edhe oreksi vate ture u shuajtur e qindrova një herë ndër krafët e Jurendinës se si përpara njëj taluri kur je i ndëndur.

“Ngë të pilqenj më, zoti im?”. E le të vetme e pa një puthje dolla jasht përposh shiut. Se si kish zën ashtu mbaronej, përposh shiut.

Dhon Fernandi thoj se vet Nietzsche vate ket zëmëra e realitetit e e citonej shpeshë herë: “Atën çë thërritëni jetë, më parë kin’ t’e kriarni”. Thoj se jemi gjithë artistra e ngatarromi mejtimet tanë me gjë çë na duket se vërteta eksiston. Këtu zë nevroza jonë, lënësia çë shpeshë herë e qellmi si shëndetj’e trushëm. Sosin vet se një lënësi t’jetë e bashkndajtur ka shumë, se të ndrofet si një shëndet.

⁹ Alleivate, nutrite.

Ahirna isha shumë i zënë të vijonja magjepsjet e gjelles, çë arsytet e saja të vën përpara syvet, për të kapirnjia fjalët e dhon Fernandit.

Rrijim ahirna rreth rreth ket bufeta o vatr'e tij sa të xëjim gjë na çë ngë kish' si të vejim ket skollët e larta jashta katundit. Ng'e di çë xumë, kishim kryet gjetëkë.

Po m'u pruar njetër herë i njëjti shurbes. Ngamon ndër vreshtat. Jurendina ndreqënej skamandilin mbë leshit. Figur'e saj e hollë ndër udrin, lloret të xheshura, xerku i gjatë, më trubulluan zëmrin. Shkova gjithë ditën i tanduar ka deshiri. Venja ndë mes të vreshtës i vrëjtur. Grat çë vijljin më qelljin dhunë: "Të hëngri bukin gadhjuri?"

Ngë hëngra me 'to kur u ulëtin përposh ullirit mezdit. Ngë donja të piriqinja syt e Jurendinës.

"Ha vetë si llatrunët. O i trëmbet gravet ki guanjun? Si thua Jurendi?" qeshi njera ndër grat. Jurendina rij me kryet ulët, po pa lën gjufin e ehjur: "Pse ngë bën rroçkat tënde e e lë të rrier? Shi këtë kufdenxje¹⁰ çë merr".

"Jurendi të zu gjalpri?"

Midhis një gaz e njetër situata u ndreq. Trëmbësja se të dil gjë mbi lidhjen time me Jurendinin. Mbrëmanet vajt'e troçisa ket der'e saj.

"Bore udhin? Ti ngë mund të hish më në shpinë time. Shi' ku ke të vesh. Ng'e shurbes i mir atë ç'jem'e bëmi. U ngë dua të bredh më. Jam mëmë bilash. Shi' ku ke të vesh, shi' ku ke të vesh".

Ngë kisha karakter të kundrastonja gjë, e më e më Jurendinën. Thellë i bindur edhë u se shurbesi ngë mund të venej më përpara, ula kriet e në një frimë: "Le' vet të të kariconj".

"Këtu, më derë?"

Pa paçenx Jurendina më kalli mbrënda e më stisi me krafët ket dera: "Jo më tutjë se këtë. Ma çë ke se dridhë ngaherë?"

Gjegja buzën e saj e grofët ç'i puxharej simes e mbjatu çë llargofej: "E nani shi' ka ke të vesh".

Hapi derin e më shtu jasht. Gjegja se edhe vuxh'e saj dridhej. Vajta ket nat'e katundit pjot ylle i lezë, po jo pa lotë ndër sy.

*** **

¹⁰ *Confidenza.*

Mëma e Jurendina fjasjin ulla të ullinjesh. Vjet ngë sualltin. Simbjet ngë lidhjin. Ng'ësht kush mund t'i bënj argomat, kush di e i puton.

“E pra vet'e firnon si ka Masavetrat, se, pra çë shture gjakun, ven e t'i vënë zjarr. Erdhëtin e t'i liptin ata dhera? Kështu bëjin, më par i vën zjarr e pra vin'e t'i lipjin për katër sollde. Jan ata dellinkuentra litinjë. U, di u, si u bë jeta sot? Gjegjej ndo një herë se i vëjin zjarr vreshtavet?”

Jurendina ka lotë ndër sy: “ Mos t'ja shesh farnitat. Vet sa djersë shtum ndër ato mbersa”.

Rrufien Jurendina se asì viti fllakat ishin të larta si pëllese. Kishin zën përpara ulla të ullinjë, pra u kishin hipur ket vreshtat e ket dushku i lisevet. Nj'erë e ligë çivosnej zjarrin. Ndilat vejin ture dhezur bartë çë mbytin gjithë vreshtat çë mos njeri më pastron.

Mosnjeri kish vatur të shuanej zjarrin. Asò mbrëma ishin gjithë te festa. Këndojin ture stonatur me karaoke. Të dejim gjithë, jipjin vuxhë të liga. Vigjilet e zjarrit kishin ndrishe zjarre të shuajin. Gjithë fush'e Sybarit ish e rrethuar ka zjarre. Nata pa hënë bën'e shqilqejin këtù e këtjè si ylle të njetër qielli. Hipej më katund adur'i kamnoit e hiu mbjonej nga gjë.

Njeri tha: “vem'e shomi zjarrin”. Me birrat ndër duar u nistin disà ka festa. Ture thërritur kopile e djelmë u mbjothëtin ka rrahj'i farnitës ka zjarri shifej mir. Ruajin çfaqjen e zjarrit si kur aì çë digjej ng'ish petku i katundit. Njëherë binej kumbora e nisej gjithë katundi sa të shuanej fllakat e dëmet ng'ishin të mbdhenjë. Pat' të vijin alloprenet¹¹ ditin pas sa të shuajin atë zjarr çë ja kish rrën shpivet të katundit, ket indiferenxa e gjithëve. Kur zjarri u shua ishin gjithë llakat e farnitavet të zeza të djeguri. Këtù e këtje ndonjë ur pjot hi shtinej fumatë.

Mëma i thot Jurendinës t'e sosinj me ato fjalë: “U kam t'i shes ata dhera të malkuar. Ngë dua të kem nga vit trëmbjen e zjarrit”.

Jurendina ka lotët ndër sy.

¹¹ *Aeroplani*. Notare la doppia metatesi che rende la locuzione un gioiello linguistico.

Pra më ruan mua: “Ti çë thua? Ësht djers’i tët eti”

“U ika”

“Ju iktit e harruat eshtrat e të mbëdhenjëvet”.

Kërkonj të përdor folmjen e saj: “Za, si kem të bëmi. Nga një për udhin e tij. Dimi ku lefemi e ngë dimi ku vdesmi”.

“Ke ligjë. Kush mund të pandefnej se im shoq kish të lënej likurin ndë Xhermanjet. Po ai ngë kish petkun, po ju ç’ishit pjot dhera, pse ngë mbetëtët ket lloku juaj”.

Hin te diskursi mëma e më shpëton ka nj’angëth ç’është e madhësufet me fjalët e Jurendinës.

“Pse u bëgat kush kish dhera? Kush jan më të vapëkët sot më

katund? ng’jan ata çë kishin dhera?”

*** **

Kisha vat’ ndër dherat, një vit, sa mos të gjegjënja më mëmën çë më nëmërenej pse ng’i kisha kujdhes petkut. Ket e folmja e saj dherat ng’ishin dherat po: djersët e tët eti – ec e shi’djersët e tët eti.

Anselmi kish ardhur të trokollisnej ket purtuni par se të zëjë agimi: “Ngë ka të na zërë vapa. Ndër ato llaka me vapin afka të zë frimin”.

Vemi përposh gjithë yllet ç’afërsojin agimin. Një qetësi e madhe çë nëng më harepsin më ditat çë kur banonj ket një qitet llargu. Ka ligjë dhon Fernandi: u bëre si pulbardhë: le hapësirat e detit për plëhurat e qitetit. Po mund t’jetë se di më barku se shpirti ynë.

Anselmi ka pak të folur. Vemi si di të huajë ture u zdripur ket brinjat e Farnitës.

Vemi për shtege ku ngë shkon më mosnjeri. Kam veshtirsi t’ecinj ndë mes të ferravet, spilithrat, galiret, çë më zënë këmbin. Edhë qen’i Anselmit vete ture kapëcier sa mos të pengofet ket ferrat. Anselmi vete më i lezë. Me gjithë se ka shumë vitra mbi krafëvet ecin ket udha sparë si një i ri. Zdrivet me lehtësi ture lëshuar hereherë një mallkim.

Hereherë ture qëndruar ruan poshta ku ishin vreshtat e rrëkon se si një kafshë e lakosur: “Sa djersë shtum ndër këto mbersa”.

Jan shum ullinjët pa armuar, vreshtat pa skalisur. Anë e mbanë është një shkretëri e madhe.

Ndër të ndryshme vitra do të kishim përpjekur grupe grashë që zdripëshin anangast për atë shtege përpjetë, për arrat, për të vjelat, për të korrat... do të kisha gjegjur gazën e Jurendinës... kët herë ishë një shqisë vdeqje....

Kur j'arrëmi vreshtës është e zë agimi. Ket drita e freshkët vrenj ullinjët ç'u egërsuan, arvuret e pemëvet jan të mbytur ka spilithrat.

“Ja qellëmi gjë sat'ëmë?” më fton Anselmi e hipet ket një dardhë.

Jan peme të vegjilë: “U bën gorrica” thotë ture zënë me dhëmbë një dardhë e vogël, që s'patë si të fryfej, e ng'ju hiptin ujërat sa t'ëmbëlsofej.

“Pse dot'i qellish këta peme mëmës”

“Sa të shoh se vreshta u spavë”.

“Kem'të qami mbë vreshtën që vdiqë? Ket banonj u kan shumë fabrika që mbaruan. Fabrika të mëdha si katunde, ket hëngëtin milëra e milëra vetësh. Nani ka dritësoret të thyera hijin vet pëlumba kukuvi e mi që ziejin, gjalpra....”

“Po dheu është dheu, ngë një fabrikë. Dheu është dhurat'e t'Ynzoti”. Mendonj ullinjët e Zefit, llargu në Siqili e thom se Zefi pat fatën e mir të ruanej dherat e t'jatit.

I jati e prit nga vit ket kalidhja si Laerti prit Odhiseun.

Mejtonj kullumbrart pjot tulë e lëngë që më ofroj ket ai petkë i bekuar, prëzë shpisë që stisi ket ish kalidhja. Ai e shpëtojë pektun ka humbja, shpëtoj kujtimin e t'jatit e bekoj gjakun e tij.

Neve, kush na mallkoj?

*** **

Për mos t'i jap vesh diskursevet e tyre, dal ket terraci. Nani ngë bie shi, frin vet era që ngë tundin retë, që rrin e patundur e të zeza sa më është i zgjer orixonti. Nxin njera ka Sila, njera ka deti, Pulini ka çukin të mbuluar. Ka an'e Fermës gjelbërojin çukat e grurit. Era siell frushata shiu. Po resistonj. Lë të më shkundinj gjithë dhëmbjet që kam kalosh.

Thonë se nostalgia vjen me thën dhëmbja e kthimit.

Ket rast'i im vjen me thën aqë dhëmbja se do të priresh, aqë dhëmbja se u propre.

Kur prirem më sosjin dy tri dita e pra zë e ndifem i huaj.

Më sosjin dy tri dita sa të vete gjënj të vdekurit, të vete të ha sipër varrit e tyre. Të troqisinj ket varr'i tatës, të Janit, t'Orestinës, çë mortja muar par motit. I thom ëmrin, i luginj gurin me likuor, se si bëfej një herë. Ket varr'i Merikanit ngrënj butilinin e whiskyt e thom: Prosit.

Pra zë varesja. Ngë di çë kam t'i pircjegjem atyre çë më piejin sa makna kam, ndose bjejtja shpin, ndose pata sukses. Pse u prora ndose ngë kam kifari me kët' jetë.

Ng'i kam dashuri kësaj shpije ket nani shkon ditat e saj mëma. Ëndrinj shpesh shpin ket u leva, ka Bregu. E e ëndrinj nga herë të shkaterruar, pa qaramide, me muret të gramisur. Kur prirem hipem nga herë ka Bregu e vete kërkonj atë gjitoni. Përpjek ndo një pjake e ulët si njëherë mbi skallunet e derës. Bënj të më njofjin: "Oj bir, oj bir, pa kush të njif". Kariconj rrudhat çë shënjterojin fytyren e tyre.

Kur hinj më sulet nj'aromë kuleçesh. Mbi tryesis jan gjith kuleçet çë mema është e nxjer ka furri. Lë t'e ndifinj Jurendina. Pra shtifet ket poltrona: "Nani lemni të rri se jam e vdekur"

"Pa qase të mbiton njeri të bësh kuleçe" i thot me rrunganxje¹² Jurendina.

"Indandu", i pircjegjet ajo, "qase mund të lë pa kuleçe gjitoninë".

"E gjitonia qase ka më bëzonj si njëherë"

"Thuani çë doni, u qase e bënj se kanë bëzonj, u e bënj t'i bënj harë. Pra i kam shum abullkacjun gjitonevet. Vijin gjithë e më gjëjin. Më verë kush më siell di fasule, kush di kutunjolë, kush di mullunxhana, kush di gërshì".

Pra e prier ka Jurendina: "Nani kur të dalësh, një kulaçë e merr për tij e tjetrtë ja qellin një Barbulis, një Dilës, një Matallenës".

Lista është e gjatë.

Jurendina ndron diskurs: "E pe se t'erdh nusja ka Merka?" më thot mua.

¹² *Arroganza.*

Do të thotë Frangjiska. Ng'e pe akoma. E pata gjithë mejtimet, veç kujtimim e Frangjiskës.

“Ngë qe nusja ime”

“Vi’, mos thuaj se ng’u deshtit. Po ç’i t’i bënej pjeqëvet ajo. Po sa i qelli ndë Merkët. I vdiqëtin pra një vit o dy. Nd’i kish lën këtu mund t’jetë se ishin angora të gjalë. Si Rozina, çë vdiqë Torin. Murga sa shkoj me kastrofilotin”.

*** **

Rrufien Jurendina se atë martes ja kishin qellur Rozinës.

Kush e di ç’ju kish dukur Bekubekut, se i jip të bilin njëj litiri mjeshtir skollje. Po ai Rozinin e muar vet për dherat e shpin. Sa u martuan ai i shiti shpi e dhera se kish’ t’ikjin ka katundi, se ai kastrofiloti thoj se na ishim t’egër e tabanra. Ai doj civilitetin. Ngë thoj se njera kur rroj Bekubeku ndër dherat ngë vej kurr e shkonej gjithë ditën ket bar-i ture lozur ndër kartazit. Sa mundi, muar Rozinin e e qelli Torin. Po thojin se ajo Torin ng’e shkonej mir”.

Për së dreqti Rozina Torin ng’e shkonej mir.

U venj’e e gjënja shpesh herë. Për fat isha profesor’i të bilvet, aq Gustinit sa Kristinës. E ajo me të bilët më ftonej në drek ndër të diellat ose ndër festat. Kur ja rrënja ket shpia e saj i qeshëjin syt se mund të fjit arbërisht. Shkojim orë ture folur, ture rrufiejtur shurbise katundi. E më rrëfienej se si të parin herë u kish ndiejtur e bjerrë ket qiteti i huaj, ket ajo shpi ket shkonej ditat e saj e vetme.

Ajo shpi ng’ish shpia. Ngë kish aromat e shpis. Dritësoret ngë jipjin ket kopshti pjotë lule. Ruajin ket një hatër të ku drita ngë hinej kurr. Një mbalatur, ket façofshin gjithë diert e apartamentevet, vej rreth rreth shpis. Kur façofej shif vet diert e tjervet.

Qielli, kur mund t’e ruanej, ish ngamot i hinjët.

I shoqi e qellënej ket qisha litire, po ajo ng’ja rrënej t’i lidhej asaj meshë. Ki faktë e mundonej pse ngë kish si t’i nxir atë dhebët me Shin Frangjiskun ka Pàola ç’ i kish dhën shëndetjen, kur vajzë e kish

zën një smundje e zezë, ç’jatronjtë ngë dijin ç’ish. Thojn se Rozina, ngë shkonej shum e do të kish vdekur.

Më shpi zun e parkalestin gjithë shënjtrat, e më e më shën Frangjiskun.

E si qe e si ngë qe kur e kish zën një ethe e fortë i kish dal Shënji e i kish thën të vej Pàolë e të veshnej stolit e tija. E Rozina u zgjua e shëruar. Kështu nga të diel veshej e zezë si Shin Frangjisku e vej më qishë.

Pra ish ai diskurs i kungimit.

Thoj se, të parën herë çë kastrofiloti e kish qellur ket mesha litire, kish vat të kungofej. Se pra ostja ju kish ngjitur ket qiellzja. Kur kirkoj t’e shqit u kish si fukartu me gjufin të prier alla larta. I kish zën nje koll’e fortë sa pat të dil ka qisha. Ç’ ahirna Rozina ngë desh të dij më meshë litire o kungim me ostjen. Ç’ish, jasht mëkatjen, ai kungim pa shijë, insipidë? Ajo ndër të dielat mbllifej te odh’e saj sa mos t’e shif kastrofiloti, ngjienei bukin ket vera e kungofej. Te menyrr’e saj.

Për atë kungim me sapur, kish zën të bënej bukin më shpi. Edhë buka litire, ajò bukë çë ng’ja rrënej mbrëmanet pa u njomur si një fik i jallartur, çë ngjatej si gomë merikane, e thartonej qiellëzin ture e përtypur, ng’ish bukë kungimi. Buka çë shkanonej Rozina më grurt çë vinej ka posthja, sa më e shtypnje sa më të bëfej e ëmbil ndë grykët.

Rozina par se të kungofej parkalesnej t’Ynzot: “U e di se ngë kam si t’i thom këto fjalë. Po bë se buka e vera e Rozinës t’jen kurmi e gjaku yt”.

Litiri ka kastrofila, i urtë si gjithë litinjët, ruanej Rozinin me ironi. Si kur vinej më katund ka Kastrofila i veshur fashist, me stivelët e me skudhishin për me trëmbur tabanët e të treshët e arbëreshëvet. Ai vej më qish, vëfej për gjunjaz e lënej atë shoqe pa kulturë të rrinej më shpi.

Rozina pra, ture shkuar vitrat, vate tue u bën më e më, për të shoqin, “çoma arbreshe”, pa qishë e pa kungim.

Marrëdhënia e Rozinës me t'Ynzot e me Shën Frangjiskun u bë klandestine e kur kastrofiloti e të bilët ishin jasht shpis, zënej parkalesja, zënej rit'i kungimit. Ajo kushenxjen¹³ e kish apostu.

Ish ki tërbim'i Rozinës, ket të sprasmet ditë e saj te spitali.

Për dashurinë e saj e për atë të bilëvet, çë më kishin abulkacjun, venj'e gjënja shpesh Rozinin te spitali.

E lidur njëj mäkënie qanej se ngë kish si të kungofej si doj ajo.

Shpesh shkonej një dhjakër, ajo bënej kund se fjënej. Një dit ai ju kish afuar e i kish lipur kush ish ai shënjt i konëzis çë mbanej sipër kollonetës¹⁴. Si mund t'ish se ai ngë njëj shën Frangjiskun?

“È il santo mio” ju përgjegj.

“E questo non lo conosci? È san Giovanni Bosco, nonna. Fa molti miracoli” e i kish vën sipër konzis e shën Frangjiskut atë çerë litiri çë kish buzëqeshjen e kastrofilotit. Dukej se do t'i qellnej dhunë me atë buzëqeshje e me atë vrejtim i drejtuar ndër syt e saj. I gjit, fora lli pekati, patrunit e shpis kur vej e i lip' llugierin.

Shën Frangjisku ruanej ndër qiell, si gjithë shënjtrar.

“Bir, nxirim atë litir ka syt. Pririm shën Frangjiskun tënë, ndomos se më harroj”

Rozina ngë delgonej pse kur ish e re e ngë doj të vdis shën Frangjisku e kish shpëtuar ka mortja e nani çë do të vdes e lë ndër ferxhat e sëmundjes.

Rozinin e kishin hapur si një stjerr i vjerrë ket griepsh'i i qëngës. Ngë kish si të tundej me gjithë tubet ç'e lidhjin maknis ç'i rrëkonej prëzë me një rahall vdeqje. E ajo vdeqjen e deshironëj e parkalesnej shën Frangjiskun t'e librarnej ka ajo pisë.

I prirej shënjtit me fjalët ç'i dukëshin më të bukura e më të njoma. Ato fjalë ç'i trubulojin zëmrin Rozinës e i bjojin syt me lotë të ngrofta.

E thërrit: rrikëza e shpis, molla e tavullatit, maçja e policës, buk'e furrit, panjokëz' e shin Nëkollit, dallandish'e verës, butj'e mushtës, arr'e pandanës, pirkok'e farnitës, ulli nd'ujë, hjiromer'e marsit, kulaç'i pashkëvet, vea me pepra, qiqir ndë poçet, zogë ndë

¹³ Coscienza.

¹⁴ Comodino.

gaxhjollët, mullënj'e verdhë, sënduq'i bukës, xharr'e valit, valë mbi bukin, konx'i pastës...

Zënej fill këtë rruzar e e skroqollisnej pa sosur gjithë ditën.

E Shën Frangjisku ng'i pircjegjej.

Një ditë Rozina më rrufiejt një'ëndërr.

Kish par Shën Frangjiskun si ka buzëdet'i Sybarit. Vej ture kapërcier si kur t'ish shangat. E kumbanjarnej një qen që dukej se do' t'i strosej, sikur do' t'e mbanej llargu ka ai Shën Frangjisk që pircposh kapuçit qeshnej si kur do' t'i qellnej dhunë.

“Shën Frangji, pirczë këtë qen, le të të afërofem”

“Çë do ka u, kush të njej”

“Jam Rozina e Skanderbekut, dua të vdes. E mban mend se kur isha e re, më shërove? Nani dua vet të vdes”

“U ngë të njof. Kush je ti litire?”

Një dridhim e madhe kish marr Rozinin. Ture i shkuar përpara i kish fjandasur se Shën Frangjisku ndër këmbë ngë kish më carithet e këllogjërit po dy thonjë cjami. Shën Frangjisku e kish lën ndër duart e djallit.

U kish firasur si një pistile Rozina, si një arrë, si një skorcë bukje e lën më diell, e vogël si një nusez.

Rozina e bil'e Bekut kujt litiri i kish ngrën gjithë petkun ture i vat prapa çotis'e çivilitetit.

Kur pra Rozina ish me rahallin, ket prahu i dritësorese së spitallit u kish ulur njëri nd'ata zogjë të mbëdenj e të bardhë që fjuturojin sipër lumit ture ardhur kush e di ka cili detë. Një ndër ata zogjë që lën hapësirat e qiellit e vijin e han ndër plëhurat e qitetit, kush e di pse, si na që liremi paqen e katundit e vemi ket pis'e qitetëvet. Zogu kish trokollisur me cepin ket vitirjata, pra kur Rozina dha shpirtin, kish hapur pendat e kish fjuturuar llargu.

“Ëh - më këputi kujtimin Jurendina - ai ish zogu i shën Frangjiskut. Ja dërgoj ai sa të kumbanjarnej shpirtin e saj ndë parrajsit. Murga sa shkoj me litirin. Ishin më të bëgetët më katund. Të pënxosh ato vreshta të shqepura. Minimumallu se njerën vresht ja muar i jat'i Dhimitres”.

Pra më ruan ndër sy: “Ka vat dje, ka të qelli. Të pan se bëri e ju hipe ket makna. E pe short máknie ç’i bjejt i jati? Shi se shurbiset frisku të bëjin dëm, ngë më mot t’i vesh prapa të revet. Ngë ke më dhëmbë për viskotet”.

Mëma më ndifin:”Ti mbjatu me gjufin e gjatë. Çë do t’e bësh ku van”.

“Ë po, çë dua t’e bënj, u murga. Do t’i thonja profesurit, se mos ngë ke dhëmbë të shëndoshtë këto mendula të ngurta mund të të bejin dëmë. Pra nani jemi edhé ket jav’e madhe e ngë kem’ të kamaromi”.

*** **

Dié, për së dreqti, kish ardhur Ana e jëm’e Dhimitres e i kish sjelur mëmës një gjimës shtjerri për arvaxhin¹⁵. U kish ngrakuar si një burr e kish hipur shkallin sa mënxit përposh barrës.

“Nji e bekuara, mund të kish ardhur burri, qase ish’e iknja. Çë presë kishe”. E nëmren mëma.

“Jo, pa xura se kish ardhur profesuri e doj’ t’i fisnja. Profesu, thuaji gjë sime bilë. U, di u, çë ka ndër tru? Ng’i gjegjet më t’jatis. Ngë do të ver më te Universiteti. La atë nokë dhëndri. U, di u, çë kem’ të bëmi me këtë bilë”.

Mbanja mend një vajzë të zgjuar çë shtifej ndë mest suvalavet pa trëmbur e pa kujdhes se mund të cënofej. Vinej me mua përposh ujit ture i vatur prap pishqëvet midhis skëmbevet. Dukej një sirenë me lesht e saj të gjatë, barë deti të verdhë ç’i fashqonej të tërë kurmin. Dil ka ujët për të mir frymë e pra pupana përposh ujit pa sosur, gjithë ditin.

Te perëndimi, vëj shalët ngriq, si bënja u e vrenej diellin ç’hinej më det. Kujdhes’i saj ish të m’imitonej e thoj se kur do t’u kish rritur, doj t’ish një skollare ime: “Pir nani dua të xë të rri me kocin poshta e këmbët alla larta”.

Qindrojim vet ket buz’e detit, njera çë dielli ngë perëndonej.

¹⁵ *Erbatico*.

Ruanja atë kriatur me këmbë e krafe të likësht, me leshtë bjond ç'i ngjatej ndër krafë e ç'ajo krefënej me paçenxë e kujdhes të forta. Ish një njollë ari ket qielli çë nguqej e losënej kaltrit ket zëjin e diljin të parët ylle.

“Ti pse ngë ke bilë?”

“Se ngë kam një shoqe”.

“E pse ngë ke një shoqe?”

“Mos tandò profesurin” e nëmrenej e jëma.

Dhimitra vëfej e qeshnej, pra këcenej e vëfej me kocin poshta e këmbët larta e drejtë si një hu.

“Ti ngë ke bilë se ngë di të nëmreshë. Pse ngë thërret si mëma? Njau njau njau, gjithë ditën. Më merr kocin. E u ngë kam fare paçenxë”.

“E mos ng'e ke nani çë je e vogël, kur do t'e kesh?”

“U ngë dua të kem paçenxë, ndo nani ndo kur të rritem. E ngë dua të kem bilë si ty. Ngë dua të birem prapa skutinavet”.

I djovasinj më zëmër të njëjtin mejtim nani çë me maknin zdripet ka udhët e Fermës.

“Doj' të më thonje gjë?”

“Ti i vete prapa mëmës? Diskurset tanë ti i di të cilët jan. Ti thua se u bëre i huaj. U u bëra më e huaj se ti. Mund t'jet se kur ishiti të rrinjë ju, ti mëma, tata, ngë dijit ç'ish jeta prapa malëvet e mund t'jet se katundi ish gjithë bota. U jetin e pe par se të rritështa. U e di ç'është prapa malevet e katundi ngë më sosin më. Ngë më sosin minu bota...”

Ruanj kryen e saj rumbullaqe. Ngë ka më lesht e gjatë. Ka lesht e skurtur si një djalë, një kasket pjot hjë, ç'i rushkullofen ndër ballë e ket xerku. Ng'ë më ajo fëmija e thyeshme çë më vinej apriesu përposh suvalat të detit aqë mot prap. Ka krafe e shalë të fortë. Ë e lartë, shumë më e lartë se prindi, sa e ruanj i pabesë e thom: ka erdhë? Katundi është pjot djelme të bukur. Sot kan çë të han. Skolla, gjimnastika, fakti se ngë ngrëjin më shatin e ngë vën më barre ndë krye, rrunganxja, i bën më të lert. Dhimitra është e shëndosht e e

bukurë më se tjetër djelm'e katundit. E fakti se ng'është e kurrivartur¹⁶ me mentalitetin e katundit e bën më interesant.

Qellin maknin me zotri. Më pien ndose i trëmbem. I ftonjë bashkeri ture i dhuruar një buzqeshje. Ndelgova se diskutet që doj e jëma se t'i bënja është më mir se t'i lë më një anë. Ka jetr'anë që mund t'i thom? Duket se Dhimitra di gjithëshorçit. Këshilet timë do t'i dukëshin atë të njëj pjaku e do t'i dukëshin të rremë.

Qellin maknin ket fush'e Sybarit.

Ndjeken mbiellat e grurit te ku kullotjin dhen perposh shiut që ngë sosin kurr. Ndjeken qandat¹⁷ e pjeçkavet pjetë lule.

Ket kodrat t'ëmbra të Kamaratit ndë mes të ullinjëvet bardhësojin gërshit.

Përposh shiut e mjergulavet, që mbulojin çukat e malevet, gjelbri ka një dritë të butme.

Dhimitra bën e vë re ket gjithë ngjiret, më e më ket gjelbr'i zi i portogalevet.

Ket orixonti, ket deti nget qiellin, një vij rrëgjëndi hapin retë: mund t'jetë se, këtje posht, ng'ë e bie më shi.

Nani, kur udha bëfet e drejte si hapet fusha, Dhimitra vete më e shpejt.

“Më mir se llargofemi ka katundi, ndomos se ngë më intereson që mund të pënxojin. Po ngë dua se gurt e katundit kan të gjegjin fjalët tona”.

Ndëlgonj se do të më qellinj ka deti. Mund t'jetë edhe se do të gjikonj sa i masur jam ture lën të bënj pjakun e profesurin pjetë urtësi.

Bën e vë re njetër herë ket ngjiret e retë të rënda e të zeza.

Më thot: “E mban mend kur ka deti më burthonje retë e bardha e më thonje se i bardhi nëng eksiston e se retë të bardha kan gjithë ngjiret e kësaj jetje? Ruaj ket ai i zi sa ngjire jan. Qeva një skollare e mirë?”.

Dhimitra bën një buzëqeshje të kënaqur : “Doj të kisha qën skollarja jote”.

¹⁶ *Corrivo*. Il termine “*kurrivartur*” era molto presente nella parlata di Acquafredda, soprattutto tra gli anziani. Papas Matrangolo lo usava per rimproverarci il conformismo.

¹⁷ Piantagioni. “*Qandata*” è toponimo di Lungro.

“Mund t’jetë se do të kishim shkatërruar miqesin tënë”.

“Mund t’jet se u kishe bën i merzitshëm si Ana, o si tata”.

“E Robertin, pse e le Robertin? Për merzì?”.

“E ndëlgova. Mëma të tha se le dhëndrin. Të parkalesi të më thonje një fjalë të mirë për Robertin, për atë nok dhëndri”. Qeshin fort, me gazë isterik Dhimitra: “Skandalli i madhë i katundit. Dhimitra la Robertin. Murga Ana. Doj se të bëfsha Anë edhe u prapa Robertit, ture i bën bilë Robertit. Aqë Robertra, sa të mbjomi jetin me Robertra. Gjithëseja ng’ë e pret më gjë se të bilët e Robertit. Se sa Robertra na dirgon Ynzot. Si ime kushin ç’është me “*Comunione e liberazione*”. I bëri tash pes bilë të shoqit, e nga here ish po të vdis. Dy fatosa, ajo e i shoqi. Thon: se sa na dirgon Inzot. Sikur se me time kushëri më shtrat vete Ynzot e jo i shoqi. Roberti është pa senx, dinak si gjithë të nëmurit, ture mashtruar gjithë kliendet. Një gjeometr katër soldesh. Çë merzì, çë merzì Roberti me dinaksit e tija. Kallon ket bashkia, i ngrën precet kliendevet, merr *il pizzo*. Roberti, i dashuri Robert. Pa thën se m’e ngallosi mëma: Jan të bëgetë, është një familë e mir, e të tjera e të tjera”. Nxërraret Dhimitra. Për t’e paqësonj i kariconj xerkun. Më zë një njomësi e thellë për këtë vajzë çë doj’ të kisha si bilë.

E mbanj mendë kur e vogël ket buzëdeti, ulët ket shura, me këmbët ngriq, mbllinej syt e thoj: “Nani rrimi qetë qetë. U nani, ture marr frimë dal e dal, hinj ket shpirti it kështu më merr si bilë. Më do *per figlia santa?*”.

Ajo çuçumizë, se si e thërrishjin gjithë Ungirnjetët e detit, kish këtë shpirt të gëzuar e pjot fantasì. E më rrinej e ngjitur gjithë ditën. Sa më vërenej se ja rrënja ket buzëdeti më ngallosej se doj të xënej të kapërcenej e të bënej rrotin.

Ahirna ngë kish anghet, malinkonit, helmet çë ka sot.

Më nxier dorin ka shiri e m’e ngjatin ket krafet e saja. Më shtringon gjishtët sikur të rrëjiret sipër një honë.

Prier kriet e më thot me sytë ç’i shkilqejin: “U nga menat zgjofem me nj’angth të madhë t’ jem e gjall. Pse u zgjova? Ç’është ki mister se mund të mejtofem si “u”? Pse mejtimi më priret mbrënda? U doj t’isha pa mejtime. Pse i trëmbem vetëhes sime?”

Vuxha i dridhet, i dridhen duartë. Qasin kriet ket gjiri imë.

Është kjo bila që dojt' të kisha pasur, sa t'e rritënja jashtë ka helmet. Po u ngjë dita e rrita vetëhenë time pjetë helme se si ajo e Dhimitres, se si nani mund të rritnja vetëhene e Dhimitres?

“Vre udhin” i thom sa të lehtsonj tendosjen. I shtringonj krafet.

Qëndron maknin prëz ket stabilimenti balnear “I mille pini”.

“Deti këtu – thot – ng'ë ai yni i Dhiamantit. Këtu ka pak ngjire se dielli perëndon prapa malevet. Uji bëfet mbjatu i hinjë e pra ng'jan shkëmbe. Ng'jan pishqë t'i marrësh prapa. Kem' të kutëndofemi. E pra deti është sembir deti”.

I shkonj një krafë mbi krafet e vemi kështu të bashkësuar ture ecur mbi shurës e zezë për gjithë shiun ç'ë e bie ka tri ditë. Ajri siell aromet eukaliptevet që jan e shtien të parat fjeta të rea.

Nani duket se qielli do të hapet ka mesimvria. Një thelë kaltrie shpon reat të rënda.

Ajir' i hollë, një puhë e ëmbël, i vizaton kurmin Dhimitres. Përposh xhakës, format e saj marrjin më dukje.

Ulem ket muret' i platformës ket në llonar e në gushthë luajin turistet. Dhimitra qindroj e kumbist me krafet ket një hu ku vargarisjin, më verë kur stabilimenti ë haptë, flamurin e kuqë kur deti është i ligë.

Ruanjë xerkun e saj të llart, mesin e hollë, gjirin e frit, po jo i madhë. Sisët i shtypjin suveren si dy pirete. Tirqit fusò i vën më tregim musklet të fort e shalvet. Makijazhi i lezë. Dy vija të kalthëra i mbjojin pjet dritë syt kukuvije. Ngë ka ngjirë ket buza.

E pe këtë figurë ket ndonjë muzë i Evropës: ket kuadret e Pikasot. Kuadre të pindaksur me ngjiret e trandafiljes të lezë të lezë e me gjithë kaltrit e qiellit. Mendonj një vajëz akrobatë në ekuiliber sipër një topë, o njetër e xheshët që lidhin lesht, o ajo jetra me ventalin.

Kam një dëtyrë me t'jëmin.

U bashkova me Dhimitren pse kam t'i fjas. E kam turpë të zë një diskurs të cilit i pari u ngjë do t'i kisha bes.

“Pse ngjë do të studjosh më? Di se kishe zën me filozofin, pra ndrove e je studjon jatrua. Ç'është që nëng vete?”

Shqitet ka huri e vete vëfet ket xhenxhulla¹⁸.

¹⁸ *Altalena*.

“Me je një shtim?”

Ndanj me kënaqësi këtë lodhër fëmilësh. Anangasem prapa krafet e saj e shtie se sa më mundin. Dhimitra vete e vjen ture qeshur si një fëmil’e vogël. Zinxhira e ndryskur rrëkon nga të vat’ e nga t’ardhur. “Ngë m’u pirqjegje njëmend”.

“Varesja, mërzia, profesù, ngë sosin?”.

Pra ture qëndruar xhenxhulin me majin e këpucëvet ket shura më ruan me sy të rreptë: “Më varestin profesurt që gjeshjin fjalë me rrungaxjen e vërtetjes së tyre. Jatronjëtej mejtojin vet sa të holla do të vën ndë kushallët. Shokezit time, bila jatronjësh ose prindësh fort të bëget, makineta kujtesi, pa vokacion, jan më të ligat: jatronjë për bithin e tyre...”

Ngë pandefnja sinqertjen e Dhimitres, e ruanj pa fjalë, pra i hjidhem: “Ngë do t’i kesh kujdhes gjelles sate? Ket bësh gjë ket e ardhmja, si do të gjellosh? O do vet të martofesh?”.

“T’e the. Ngë dua të martofem”.

“Je e sigurtë?”. E pra për njisez¹⁹: “Doj’ të të martonja u”

“Ti rri mir si je. E më dispilqen për tij, u ngë mund të taksem me mosnjeri. U dua të vdes njëhere, si një lule, që shkon e e mbjedh sa t’i marrsh aromin. Donja se, si një herë, të shkonej një dem o një shqiponjë e të më qëllënj llargu ka ng’ë më jetë”.

Më ruan me buzëqeshje e shton: “Dua të humbem par se të më mafet bitha. Zë më njëhere atje, pra dhjama të hipet ndër tru e bëfe si Ana, si ime kushiri”.

“Pse Ana që ka? Të rriti. Vate ndë Xhermanjet e ndë Franxhët me tët at. U bëgatëtin. Stistin shpi, pëllese”.

Dhimitra bie ndër gjunjë, me duart mbllin veshtë: “Kim lipisi, kim lipisi, mos bë edhe ty diskurset e mëmës. Ç’erdtim e bëm ketu? Të gjëgjim diskurset t’urt’e Anës? Mos ngë do të më kesh lipisi mua kiji lipisi detit. Çë ka të përtërinj këta ujë për gjithmon? E mban mend kur thonje se ngë biret fare gjë, se tingull’i fjalëvet tona do të udhëtonj përjetshme? Kim lipisi, fshi fjalët që the...o do edhe ty të ngjatish një gjisht sa të kumandosh atë që kam të bënj, se si kam të jem. U dua t’jem atë që jam. Ngë dua t’jeme se si do Ana...”

¹⁹ “*pir njisez*”: in questa sola locuzione: *per gioco, per finta*. Espressione lunghese.

“E ti e di që je?”

“U ng’e di kush jam”.

Dhimitra qetet e mendishme. Bën e i kërset gjufa ndë mes të dhëmbëvet.

“U ng’e di kush jam. Nga herë që rufem ket pasiqiri vrenj një të huaj e ndryshme. U ng’e di kush jam, po ngë dua se tjetër kam të më thon kush kam t’jem”.

Pra ngrëfet e vete ket makna.

“Nani pënxonj u”. Dhezin radhjen e vë një CD.

Një muzik flauti mbjon qetësin e llokut. Njof muziken e Debussy: *l’après-midi d’un faune*. E Dhimitra zë fill e luan. Bën rrethe të gjerë, rrotulon mbi vetëhen e saj nga mot më e shpejtë. Pra niset me forcë e kapërcen tre katër herë ture ngar dheun me duar e mbë krafet të tendosur. Qindron me shalët hapët më truall, pa u shqetësuar se ë gjithaparu lagët.

E ruanj i fatosur.

Kur ndalon të luanj i troqisnj duart: “Brava , brava, ngë dinja se je kështu brava”.

Ture marr frymë anangast: “Njera që është vallja si mund të pënxonj Robertin o Anin? Ndomos se ng’jam e mirë. Më fjandasnej se isha e mirë, po është më e mirë se u Dila. Ti ng’e pe Dilin. Kur luan Dila, u qan. Ku e merr gjithë atë bukuri? U e ruanj e thavmasur e fatosur e magjepsur. Më dridhet gjithë kurmi: si mund t’jetë se Ynzot i dha gjithë atë hjë. Si i pirgjegjet Dilës. U doj’ t’e kariconja, t’e puthnja Dilin. U ng’jam fare gjë. E kapirta kur pe Dilin. Ajo ngë luan se si i thot mjeshtla. Duket se ka gjë për mbrënda që e qellin. Sosin të zër muzika e fjeturon. Harron rregullat e mjeshtlis. Ndafet ka tjetër e vete ka e qellin... që është që e qellin? Si kur ka njëngjil që e zë për dorje...mjeshtla e ruan e thavmasur po ng’e lë të bënj, e nëmren se ngë mban rregullat. U mos ngë bënj atë që më thot mjeshtla ngë di e bënj gjë. Do të veja edhë u mbatan atë që xum”.

Qetet Dhimitra.

Pra zë me vuxhin që i dridhet.

“U ngë di e bënj fare gjë. Le universitetin për të luanj, po çë kur pe Dilin u adunarta se gabova gjithsej. E pse Ynzot asaj i dha e mua më mashtroj ture më dhën një pasjon e cilës ng’i pergjegjet kurmi?Ti e di kush është Dila? Mëkat se ka një dhëndër...një herë çë luajti si perëndeshe e perqafova e e putha ture qajtur... dhëndri pat zili... Si thua? mund t’ë martonj Dilin?”

Terin hundin e lotët me kurrizin e dorsë.

“U dua të dal ka filaqia e Anës, ka filaqia e zakonavet të katundit, ka filaqia e vetëhes sime. Donja se të më hapëshin kryet e të dilnja ka gjithë urtësit, ka gjithë dukjet, ka gjithë evidhenxat e tjervet. Pse kam të shoh me syzet e mëmës. U dua t’ë kriarinj, dua t’ë piksinj u botin time. Më fukarin Ana, ish e më mbytnaj Roberti”.

Ulet më truall e shtringon gjunjët me krafët. Ruan llargu ka deti e i daljin lotë ka syt.

I qasem e i shtrëngonj krafet.

“Si tham? Se faregjë bired. Do se këta lotë kan të ngjaten për gjithmon? Do t’i fshimi? Çë ka të rrëfinjë ki det çë të pa se luanje si një órizë. Duami t’i dhuromi, ndomos se ng’ë deti ynë i Dhiamandit, njetër valle? Luaj për mua këtë herë. E marr ben se ngë të përsërinj fjalët e Anës”.

Dhimitra ngrëfet e vë njetër CD, me muzik jazz. Këtë herë luan figurë më të vështir. Vete fort e shpejtë. Bën rrotin, vete si karroçoll, e duket se kurmi i bëfet më i lezë. Shket për gjunjaz e vien e mbaron vallen ket këmbët time.

Qindron kështu ture çfritur fort me kryet ultë.

Pra ngrën një dorë: “Mba mend se m’ë thon Demetra. Do të vinj një ditë një pjak pjotë tëtum të më marr akoma e re. Për këtë ngë kam si të taksem me mos njeri. Për këtë më pilqen të luanj, pse nëng qindron asedhë një shenjë t’atij çë bëre. Si erdhë muzika iku. Se si do t’ikinj edhë Demetra. Si erdhë do t’ikinj Demetra. Si vete e vjen ujët e detit”.

Ngrëfet e vete prëz suvalavet: “Sa ujë deti duhet sa të lafen gjithë çotit tona? Do të lafsha një herë për gjithëmon, për të harronja gjithësej e të prirsha ajo vajzë çë venej përposh ujit... Gjithë shiu çë ra ndër këto ditë pse ngë lajti gjithë trëmbësit e sigurit e Anës? Çë kur u leva ç’ë e më rritin me trëmbësit e saj...e u xura mos të

trëmbem ture vat përposh ujit... Po nanë sosin me këta angëthe...’e të ver Ana”.

Kaltria u zgjirua. Nanë nxin vet sipër malevet. Deti vete i llavur si nga herë pa mejtime pa lipë e pa harë.

Nani të lidhur vemi si di dhëndra anangana suvalavet e detit, ture ndukur merin e tij e ture i dhën shkelbe gurve e plazhës. Dhimitres i qeshjin syt: “Deti paqëson gjithsej, ng’ë vërteta?”.

I jap një shtitje: “Shi’ se *la vita* ng’ë *poesia*”

Dhimitra më përgjegjet me njetër shtitje: “E ti je një profesor, gadhjur i madhë”.

*** **

Me një dorë ngjien pinielin ket ngjiret, me jetrin qellin ndë grikët sigaretin: “ E di se jam e pi faregjën çë jam, po edhe se moti digjet e këtu e një çik do të qindronj vet hiu, kam këtë mjet mejtimi çë më mban mendë se, ndose mejtonj se jam e vdes, gjithsej ndërrom domethënie”. Helq me hundin. Është pjot rromac: “Ndose mejtonj se kam pak mot vete më i shpejtë, dora anangaset”. Është e pindaksin një Odhigjitrje. Pindaksin se si xu ka mjeshtri i tij. Odha është pjot Odhigjitrje, njera dreqë si jetra, duken bën me një shtypë.

I thom : “Ndose je po të vdes, pse ngë do të shosh, ndose mbatan kjo mënire të pindaksish ng’ë më gjë...”

“Është tradita”

“Një traditë çë vaxhdon për sekuj është e përjetshme, si mund të mejtosh se je vdes?...e “vdes” çë vjen me thën? se nga gjë mbaron? Ke shumë sigurime, e parë më parë sigurimin e vdekjes. Ti di ku zë e ku mbaron ikona jote, aqë sa di nga herë çë ke të bësh, dora ngë të babaret, bën nga moment atë çë bëri ngamon, ngë rrizikon kurr, ket gjella jote ng’jan rrëziqë, as gabime. Ngjeps gjë çë ngë bëre kurr e shi ndose di kur ke të mbarosh, nj’udhë e re çë ngë di ku e ndose mbaron... Një i madh njëherë tha se këtu gjithsej zë e faregjë mbaron... ti ngë ke angëthin të mos të dish ku je vete...”

*** **

Ka sytë e zezë, ka të zezë leshët ç'i bie rrushkull ndër krafë. Një nok'e kuqe ja mban të lidhur ket shiri. Është më e lartë se gjithë vallëzoret ç'jan'e luajin ndë mest ket odha e valljes. Njof muziken: Mozart – Divertimento kv 334 D-dur.

Njera çë luan minuetet, Dila është një ndër gjithë dishipulit e skollës. Mjeshtla i masin ritmin me një shkop çë mban ndër duar si nj'osten me të cilin qindrisin ata çë gabojin. Dila vete e butë si do mjeshtla. Ka hjë, ka mjeshtri, po ngë më duket se është më e mirë se Dhimitra. Dhimitra më qeshin për së llargu. U vu ket angoni më i llargët ka mjeshtla si kur do të fshefet.

Di si ven më skollë këto shurbise e mbllinj syt sa të më fashqonj muzika. Po te një moment gjegjinj mjeshtlin çë troqisin më truall shkopin e thërret: “Didi, Didi, me tjerët, me tjerët”.

Muzika ndroj. Nani vete rondo-j i gjashtit moviment. Dila ngë vete më e paqme midhis tjerëvet. Tjert sosjin ka vallja e lën Dilin të vetme ndë mes t' odhës. Mjeshtla thërret, batirin shkopin më truall, po Dila ngë gjegjin. Duket si e qelluame prapa muzikës. Kurmi i gjegjet njëj forcje ç'i qikarin kurmin si një fushër. Leshtë i duken dega çë qellin ka do nj'erë çë kush e di ka vjen.

Qindronj i thavmasur. Ngë kam bes se një kurm mund të bëfjet kështu i lezë.

Dhimitra më qaset. Më shtrëngon krafun: “E pe çë bën, e pe çë bën? Nga herë luan pes minute me tjert pra vete për fatin e saj”.

Edhë mjeshtla sosin të batirinj shkopin më truall. Di se Dila nëng mund' t'e gjegjinj. Më ruan e hapin lloret sikur do të më thot: “Ndëlem, ngë kam çë të bënj”.

Kur muzika mbaron, Dila qindron për gjunjaz ndë mes t' odhës, ture qeshur me një gaz ç'i shkundin gjithë kurmin. Ka lotë ndër sy. Gjithë troqishjin duart. Po mjeshtla i qaset e e nëmren: “U, di u çë kam të bënj me tij? Këtu vini se të xëni, jo se të bëni si ju shkonë ka koca. Ju kin' të xëni rregullat e valljes. Vallja ka rregulla çë nëng mund të ndroni si doni ju. Pa rregulla ngë kini ku të veni”.

“Po u ngë dua të xë, u dua të vete ka më qellin muzika. Është më e fortë se u. U ngë kam si të qindronj kur më zë zeksi”.

“Vallja është artë, e artja është matje. Ndose ti ngë do t’jesh e matur ka rregullat e skollës këtu ngë ke çë të bësh, shi’ ka ke të vesh”.

Dhimitra më lidhet më, ture më mbështetur kryet ket krafu: “Si thua ti?”.

I shtringonj dorin. Ulinj kryet i turpshëm pse ngë kam një përgjegjje: “Jan edhë tjetrt. Ng’ish’ e luajit gjithë bashk?”

“ *E che c’entra tjetrt? Po si je, si je?* ”

E lë të dhunur, ndërsa mbjedhë rrobat e saj më shtie një veshtrim të ligë: “Xure t’e pënxosh si Ana?”.

“Jo, rregullat i bëjin dëm vet çotravet. Rregullat jan se t’i pështosh”.

“Ke ligjë. Katundi është se t’i vesh llargu, një mos ka ikin?”

“E pe se e kapirte?”

“Ahirna Ana është sa të mos t’i gjegjesh?”

“E di u? Shife ti”

“Më lë vetim, e kapirta”

“Ke të rritesh”

“U t’e the se je një profesur gadhjur, çë ngë di t’i jap këshile gjindjes”.

“T’jesh pa rregulla është një lodhje e madhe, mund të biresh...”

Hapin një buzqeshje e madhe: “Birem? E ku? Ng’jemi nga motë me *Buddha*? Mund vemi mbatan dorës së tij çë na mban? Kush bired, kush bired? M’e mësove ty, o ngë di atë çë thua..?”

Ndronj diskurs. Ruanj Dhimitren me kurjozitet: “Më duket një fixhë e njofur. Kuj e bila është Dila?”

“Është e mbes’e Jurendinës”.

Njota pse për njera sa duroj vallja e Dilës u ndiejta i trubulluar.

Ture u mbjedhur më shpi pata ndër sy vallen e Didilës. Atë shpëtimë ka rregullat. Zogjë çë çofen. E gjegjënja vuxhin treballa’ë Dhimitrjes ket telefoni djë ture vazhduar bisedimin e detit: “...duan vet haren e tyre. U leva për haren e Anës e rronj vet për haren e Anës. U leva edhë për harën e Robertit. Thonë se duan të mirin tim. Po çë vjen me thënë e mira ime? Vë rë mos të shkatarrosh haren tënë. Mos njeri do haren time pse harea ime jan penda çë më qelljin llargu ka harea e tyre. Harea ime është të këcenj mbatan kufinjet e skaracit ku u leva...”

*** **

Ë e fjë e paqme mëma. Nga herë kështu. Lodhet se si nëng kish të lodhej ket mosh'e saj e pra ngjatet o ket polltrona o më shtrat. E zë frimë. Thot se ndose ngë jip e mirr, mos nëng lodej, nanì ish nën dhe. Vrenj figuren e saj të vogël. Kjo grua më dha lindjen po edhe bëri se të shkonja gjithë anghet e gjelles.

Më nxuar ka shpia kur isha akoma i vogil, i njomëth sa të zënja fill të njifnja udhët e botës. Studimet. Ngë kish' të ngrënja capulin si tata. Ngë kish' të shtinja djersë ndër dherat.

Buar një bir e buar dherat.

E ruanj nanì ket vapëkesia e saj e mbllifem ket qetesia e qanj pa lot si kur te kollegji e para mbrëma kur u ndiejta i vetmë.

E bashkuar ka ajo një menat u kisha nisur pjot harë se venja te katund'i huaj. Kur më dha të falat me lotë ndër sy i the: "Më, mos qaj, u këtu rri mir, priru më shpi me harë".

Qe e njëjta here ç'i fola me njomësi. Pra u bëm të huaj: ajo nëng më kutptonej mua, u ngë ndelgonja jetin e saj.

Jet'e kollegjit kundrastonej jetin e fshatit. Jet'e fjalës kundrastonej jetin e djersit, e ullinjëvet, e të korravet, e të vjelavet. Jet'e fejes kundër jetën e mejtimit.

Kur zura e u ndiejta i huai shpis u bëra i rremë. Për mos t'i jipnja dhëmbje e shqetësime ket letrat i thonja se rrinja mir e pjot kënaqësi ndomos se jet'e kolegjit nëng bënej për mua.

U bëra te kolegji hjersë: harrova dherat, harrova ligjen e zakonat e fshatit. Ruanj botin pa thavmasì nanì. E marr si vjen...

Mëma ka një gjum të lezë. Herë e herë e zë një dridhim. Ajo thot se kështu i shkon prez mortja, t'i mbanj mende se ditat e saj jan e mbarojin. Për këtë parkalesin më spesisht e e ka me mua se u bëra i pabesme: " Ngë sosi se të dirgova të studjonje ket prifrat. Kisha bes se ata doj' të të kishin bën më të lidhur me shurbiset tona. Po të kyejtin kocin..."

Nanì çë Jurendina iku me kuleçet çë ka t'ja ndanjë gjitonevet, qetësia ë e rëndë e më vë në ngushtësi. Kërkonj fjalëtë për një diskurs, i cili do t'jetë, për kur të zgjofet mëma.

Mund' vet' të recitonj pjesen e të birit të mirë ture i qellur dhunë aqë vetëhese sime sa së sajs ture u burthuar i bindur mbi shurbise të cilavet ng'i kam fare bes. Po u lem se të qellemi dhunë njeri me jetrin... e rremja na shpëton ka e virtetja ç'ë e bën sa t'jemi të sdorrokopsur...

Figur'e saj është anghi im i madh, angh'i ftesës: se sa ëndrrave nëng ju përgjegja, se sa tradhëtime bëra...

Ng'i jap kujdhes mejtimevet çë më kundrastojin mbrënda e prirem njetër herë ket zjarri. Me syt të mblitur ajo me thot: "Ec mir njetër di gobaçe, nëng she' se ë e të shufet zjarri? e mos i tandò atà ure se bëfen gjithë hi".

Njota çë bëri mëma për së dreqti: si grat e moçme i pat kujdhes zjarrit. E mbajti nga mon çelët, ture pritur, më vatir o ndë policët, nj'Odhisë, shoq o bir, t'i prirëj më shpi.

*** **

"Kur u pagëzuan muartin ben se do të kishin mohuar gjithë magarità e jetës, gjithë ngasjet e djallit. E shoqja tha se atà ngë mund t'heqjin dorin ka "*il loro tenore di vita*". E këta ven nga dita e bëjin kungimin. Bëjin kryqë edhë kur ven e përmierjin. Kur han thon grekisht: *doksa to theò panton eneka*. U i dhe njetër parkalesi çë thot: "Ndlena Zot se kemi kuraxhin të vëfemi më tries ndërsa tjetër jan e vdesjin uri pse na ngë mund t'helqmi dorin ka "*il nostro tenore di vita*". Ndlena ndose u vum më tries pa pasur prëz një të nëmur, çësht fytyra jote, me të cilin të ndami ushqimet. Ti çë je perëndi'e vjedhësvet e të putëravet e të gjithë të nëmurvet, çë do të vijin më par se na ndë parrajsit kina lipisi e bën se bëgateria jon mos të na farmakosinjë". U skandalizuan. E ndose më par ngë vijin e kungofshin ket u pse jam i martuar, nani ngë vin' e gjegjëjin asedhë meshin.... e këta timët jan gjykime. E na ngë mund të gjykomi, pse

kem' t'jemi të pirsosur sesi Ati ynë ç'është ndër qiell çë bën e bie shiun mbi të ligët e të mirtë”.

Fjet me thartësi, ture krefur me duar çufin e leshit rrushkull ç'i bie ndër ballë. Ka fixhin e atyre figurë e Fayyum me fytyre të likështa e hundë t'ehjurë si thikë e me mjekrin e shkurtë.

Hin gruaja, Jasmina, të na siell një kafë. Ë e bukur si gjithë të reat e katundit. Papasi e karicon. Ajo i përgjegjet ture i karicuar mjekrin.

Kur e shoqja ikin me një buzqeshje e njomëthë, zë njetër herë: “Është më mirë t'i kesh kujdhes njëj shoqje o njëj kantjeri? I madhi skandalizaret se pra çë karicova t'ime shoqe vete e ngas kurmin e Krishrit, po ç'ë më mirë të karicosh një kurmë gruaje o të nëmrosh të hollat...e ai i madhi ka shumë të holla. Po ka, ka e tija, edhe mejëtimin “*clare et distincte*”. I dha shumë dhurata Ynzot, se si mburret i vetëm. Harron se ngasj'e djallit ket parrajsi botëror qe mejtimi *clare et distinkte*, xum atje të gjykojim ç'është mir e ç'është lig, u bëm atje racionalista e me ragjunin u ndiejtim dreqë si Perëndia, të mundësor, e të fuqishëm si ai. Njeriu racional mundin gjithsejin. E u mësuam aq mirë se *la Raison* është e vetmja çë vendosin ç'është e vërtetja, e ç'është e rremja, sa mos njeri ka kuraxhin të pienj pse, ka i vjen gjithë kjo arkanxje. *La Raison* ng'është perëndi? E si perëndi do pasur bes e është pjot zili.... Po sot na qasemi ket varr'i njëj Perëndie ç'u shkrakua ka gjithë mundësimet, ka gjithë fuqitë, ture ju dhën mortjes pa raxhun.... o jo?”

*** **

Ndersa çë fjet për “të madhin” i vjen nxe historia e Çesarit. Shkoj ket një fshat i bjerrë midhis malevet e tha: “Më mir i pari këtu se i dyti Romë”. E yni, po çë ngë kish si t'ish i pari Romë mbet ket fshati ynë. Këtu Perëndia i vu dorin ndër krie e i dha sukses, i dha të holla se sa më desh, pa ngrëjtur një dorë, pa djersë: ish Ynzot çë lodhej për të. Kur kish bëzonj, gjënej nga herë kush i hapnej kushallin. E gjelloj si një princ, i sherbëtuat. Tri herë i ofrirtin kurorin e tri herë ng'e desh. Për të rrufiesh kët histori dufet urtësi'e Plutarkut. Parkalesinj t'Ynzot mos t'i vinj ngullia të më lipinjë t'i rrufienj u gjithë

thavmasit e t'Ynzoti te fshati ynë. Po nani ka një problem, te fund'i gjelles: kujt ka t'i lër gjithë petkun që mbjodh.

Jan shumë që shtun djersë e ng'u bëgatëtini. Kush u bëgat patë të mirr udhët e jetës. Jo si ki që mbet te fshati, kam bes ket një moment se vërteta Ynzot vu tendën më shpit të tij...

Ndërsa rrëfien me fjalë që lidhen matulla matulla që më marrjin kryet, jasht bie shiu. Këtë javë ngë do të mbaronjë...

Një shkrimtar kur ka të prënj dorin bën se si një që gjegjin e këputin dëgjimin?

Ahirna vejim për argomat. Saveri qellnej qet që hilqjin pramendin me një rrëkim të hollë. "Vëm kaluar ket stavari, kështu e bën më të thellë argomin". Saveri më kutëndonej ndose i jipnja bukin e grynjtë. Isha i gëzuar të ndronja bukin time me bukin trikomeli e tij... qeshnja ture qindrisur qet me hostenin që Saveri më hjiq ndër duar. "Ë e qeshin çoti" thoj Saveri...

Për vërteta kisha zën ture qeshur. Pra erdhëtin angëthet e skollës e kollegjit, pra angëthet e Ligjës që na bën gjithë të mëkatëruamë.

Si mund të pindaksinjë ture gjegjur këndimet e Frank Sinatra *tè tè tè tè tè* avukati ture lozur tresetin me tjerët e barrit "*si nu ciucciu si*" e ndersa Frank Sinatra këndon dhon Fernandi jam e vdes me gliçemin, njetër çik t'ëmbil e vajta na erdhëtin këtë ka jashti e na bën gjithë merikan merikani mbllifej mbrënda të shtunin e rij dy ditë ture pir edhë Nxelmi pij, defej nga mbrëma po ndër katër orë që menatet vej ndër vreshtat merikani *tè tè tè si nu ciucciu vuxh*'e avukatit merikani të hënin ish i dejim e ngë dinej atë që thonej Frank Sinatra ai dhon Fernandi ng'e munda më vate ket bar-i muar diskun e ja çjajti *basta* me Frank Sinatra ë e na futirin kryet *capite niente* dhon Fernà avukati litù që di gjithsej thot se Frank Sinatra është i njëjti që di e këndon *non ditemi che sta musica moderna* dhon Fernandi *va ti futti avukà sapete nutrirvi solo di noia fatta sacra da buon fascista quale siete* vejim ndër argomat diljin ka shteget e hijim ndër dushqet pa e ju trëmbur ulqëvet *ci vuole ordine e Sinatra è nelle regole dell'armonia che i grandi musicisti hanno stabilito una volta per*

sempre tè tè tè si nu ciucci il fatto è che siete antiamericani perchè il capitalismo americano ha vinto in tutto il mondo decretando la fine del comunismo e questo non vi pare vero you are very strong

muskulet e tij të frir se si ata personaxhe të vizatimevet merikan djojasjin shum romanxe me vizatime shofjin shum filme e pra shtien bumba sipër Vjetnamit sipër Iranit bën e spaven qindra e qindra njerëz n'Arxhentin e në Çile: “Bët një punim'i mir” i thot Kisinger Pinoche-ut për lavdin e kapitalismit *you are very strong* i thot atij çerë piçuçi merikani bir arbreshi dy ka katundi u humbëtin n'Arxhendin një burr me të shoqen ng'i qajti mosnjeri kish t'ishin dy komunistra me gjithë kënaqësin e avukatit se sa di litiri është kështu evidhent diskursi dy e dy bëjin katër jemi këtu se të gjellomi sa më mir mundmi e ligë për kush ngë di e rri e vete ture gjetur guaje *you are very strong* dy e dy bëjin katër kush ka fuqi e mundje ka ligjë dy e dy bëjin katër ka fuqi e mundje ku u humbëtin ata të dy gjitonë? Kush e di ndose vun fjamurin e paqjes katundi ë shpella shpella shpella kem t'ikmi edhë vetim të shomi ç'është mbatan mua ngë më sosin asedhë bota buz'e Dhimitres një lefet kështu me buzin e Dhimitres ngë ke çë të mësosh *voveo tibi impietatem et blasphemiam per totam vitam meam* mallkò mallkò më thot Ndoni ti ngë ke kuraxhë të mallkosh mallkò atë perëndi çë rrëjirin e mban gjithë këtë kozmos i shtruar me matematiken e par më par rrjirin e mban *cogito ergo sum* kush është ç'është buz'e Jurendines kështu e re puthj'e saj e lagëtë kish vet likur sipër eshtravet e likësht Jurendina pa sigurime Jurendina çë vej ka e qellnej zeksi do të hinj më par se na ket parrajsi e mund t'jetë se ka tash dy këmbët në të Jurendina pa moral si thoj avukati çë ka sigurin se jeton se *cogito ergo sum* ai studhjoj ka Jesuitet e më se atà kush di si ven shurbiset *voveo tibi blasphemiam* shkojin se si te një proçesion gjithë personaxhet si nj'angëth ngë mbajte shpin ngë mbajte dherat qeshin Zefi çë ka ullinjët e fiqët e se si Ndoni kujt vete i bën vizita mund t'i mbitonj²⁰ pemet e kopshtit të Margeritës hapet qiell'i Siqillis e kopsht'i Zefit duket se ë e pret t'i shkojin ata tre të huaj për të cilët njëherë u vra një viç: ti ç'i mbiton miqëvet? Ngë kë asedhe si të pratikarësh mirprijten...si e hapin triesin *nous ne vivons que pour perdre* sa më hipet dielli sa më

²⁰ *Offrire, ma anche: invitare.*

ngrëfet nata aq gjelle aq mortje sa më do t'i qasemi t'jemi të përjetshëm sa më kemi mjete të sdorrokopsmi botin Mari'e Ponit hapënej prushin e me sy të ligë shtinej vaitime: “Shkerda llampi ka bregu lepurit bëft lu giru di lu mundu e skirjart gjimësin e jetës” si bën t'jesh arbëresh pa peme të hapish triesin ngë mund përdorësh shurbiset e litirit *qu'on ne nous reproche donc plus le manque de clarté, puis que nous en faisons profession* ngë mejtova shum këtë frazë e njëj ç'ish një matematëk e një skencëtar i madh mund t'jetë se logjika nëng mban shurbise litinjësh këta mejtime kur nj'arbëresh i mejtoj sa i huaj u bëra shpella shpella e ankthet e saj vërtetja se t'jetë e vërtetja ka të mbanjë ket gjir'i saj edhë të rremen me kë i ndanj këta mejtime na çë qem të mësuar të lavderomi *la Raison irrazionaliste* gjegjinj avukatin, litiri çë di ku banon e drejta e ku e rremja i sigurt një mos të hollat si i bën na kem' të marrmi çikutin thot dhon Fernandi: s'e more akoma? e u bëm të bindur se logjika ka ligjë po ngë diskutuam kurr parimet me të cilët zëmi fill llogjizmet tanë e na xum t'e sherbëtimi logjikin.

*** **

Fumata çë prier era ka çiminera me ka farmakosur. Më zu si një gjum. Më zgjon një muzik e hollë e e paqme çë vjen ka radhja. Ësht muzika e Ravel. Sa herë e gjegja këtë *Trio pour piano, violon et violoncelle*, ture vatë ket buz'e detit me kufjet ndër veshë.

“Bën e më qëllon” thoj Demetra kur i vënja kufjet te veshët e saj: “ka ngjiret e tundjen e detit”

“E pe se e kapirte?”

Herë e herë i reçitonja: “¿Sabes tu, quizá, de dónde es esta blanda flora, que yo no sé de dónde es, que enternece, cada día, el paisaje y lo deja dulcemente rosado, blanco y celeste – más rosas más rosas – como un cuadro de Fra Angélico, el que pintaba de rodillas?”

“Ma ç'je thua, ç'je thua?”

“Kur t'jesh e madhe do të kapirish atë çë thom”

“U kapirinj nanì më se ti. E nanì rri qet se kam të gjegjinj muzikën”

Kush e di ndose sot do të dij të luanej një muzik të tille. Ahirna e qelnja me mua të më përsërit atë çë më kish thën të parin herë kur e jëma i tha: “E shef, ki qe profesuri imë kur isha e vogël si ti”. E babartur vajza më ruanej kurjuze: “Po ki ng’i gjet mosnjeriu”.

*** **

Njëditëz erdh e më gjet Ndonini. Edhë ai banon llargu ka katundi. Ka edhë ai dhëra, e stisi një shpi: “Për të mbjedh shokët, sa të shtimi di gaze. Gjella na u bë shum serjoze. Ngë kam shpres ka fare gjë. Bilët ngë duan të më gjegjin, thon se i varesinj. E kur u bëre i huaj edhë më shpiti tënde, çë të qindron? Ti e mban mendë shpellin e Platonit, ai çë pat fatin të shif ç’është mbatan shpellës ng’ë i pasur besë. U pata fatin të shinja se është gjithë për me qeshur. E këta ngë din’e qeshjin. Jan gjithë çeravrëjtur. Mund t’i japësh sa verë do se rin ngamot me syt më truall. Gazi im është disperaciona.. Kush di e qeshin më. Na mund qeshmi se jemi të huaj...e mban mend atë marinar çë gjet një kontinend të ri pse kish gabuar udhin...kush e di ndose gjetëshim gjë na çë buartin gjithë udhët”. E thot di çotari. Qeshmi me lotë ndër sy...

*** **

Mëma zë njetër herë diskursin e ikjes sime: “Sot mund t’ishe më i bëgat’i katundit..”

Më ndifin telefoni.

“Mund kem nderimin të vi’ t’ më vizitosh, profesor’i dashur? O u bëre kështu liti sa harrove dëtyrat tënde? Jam akoma i gjallë për të tandonj sigurimet tënd. Do të vish të më japësh një kazjun folmje? Mos më le të ruanj si nga dita vet muret. Mba mendë se te fillimi është fjala”.

Më thavmasin vuxh’e dhon Fernandit, vjen ka humbjet e motit, ka harramja ç’është njetër mënyrë të shpëtosh shpirtin ka angëthet.

Më pilqen se dhon Fernandi më fton. Ndër ndryshme mote do t'u kish frytur se ng'e kisha vizituar, ture më marr për frymëmadhë. Këtë herë pranonj me kënaqësi ftesen e tij.

Ndomos se shringoj shiu drejtohem ka shpi'e tij ka Bregu..

Hipem ndë mes të llavinavet, ç'u madhësuan. Zdriven posht ka Shkëmbi ture xarrisur shurë e gurë. Një kujtim djalërie më qellin ndër këto rruga, pra çë hapej moti, ture kërkuar lile e gozhda e sa më kish lën llavina. Nani vete me umbrelen, ç'era ë e më lë sa mënxitë hapët, ture kundrastuar me shiun. Vete ture kërkuar atë çë la llavin'e gjelles.

Ja rrënj ket shpi'e dhon Fernandit i tërë picirrë.

Më mirëpret me një buzqeshje të made e më fton prezë zjarrit çë ka fllaka të larta: "Njota një i denjë bir dhon Kishoti. Ngë le vesin t' i venje prapa librevet e po edhë i shkruan, xura: " *del mucho leer se le secò el cerebro*". Ka jetr'anë po çë qeve nxënës imi se si mund të shpëtonje ka libret? Vet se u pata kujdhesin mos t'i shkruanja. Ësht shum i madhë kaos' i botës për t'i shtosh lënsi lënsis. Kam të thom të dreqten, ngë pata asedhë kurajë t'i shtonja botës dhëmbje mbi dhëmbjes ture bën bilë. Se si thot ai i madhi: mir për njeriun mos të lefet e njëherë ç'u le të vdes sa mënjëhere".

Se si nga herë dhon Fernandi i jep enfasis fjalëvet të tija e duket një aktor sipër një teatër çë reciton pjesën e tij. Ka jetr'anë ish mjeshtër i mejtimit negativë, kur spjegonej Schopenhauer e Nietzsche ngë kish kundërshtarë. Ngë ndelgova kurrë ndose për së dreqti recitonej të na thavmasnej o ndose ndienej vërtet, ndër thelsit e shpirtit tij, atë çë na mësonej me aqë pasion. Po shpesh hinej ket errësit e verës, shpesh ishë i dejim e ket mbusha enfasis-ja e tij ish më e fort e deklamonej lloke të gjet e auktorve çë mallkojin botin.

Bënj një buzëqeshje të turpshme fjalëvet të tija. Ika ka një zjarrë se të vinja ket njëter.

Dhon Fernandi do vet të më burthonj se është akoma mjeshtri i urtë e se një nxënës i tiji qindron gjithmon nxënës ndomos se shkruan libre. "Mund të luftonj kundër një dhon Kishot, çë pat kurajin të vin' të më gjënej pa llanxë e pa hell? *En guardia, en garde de toi*. Çë më thua, çë novë më siell ka e bekuara civilitet çë na magjepsi gjithve. Na ju presmi juve çë vini ka jashti sa të xëmi gjë çë do të na thavmasinj"

“Strote di gjithsej: çë novë mund t’i siell strisate? Civilitetja është nga mot e njëjta, na ngranon me magaritë e saja. E na si të lën i vemi prap”.

“E ti pse ike, ahirna?”

“Pra atë çë më mësove zotrote, kjo është një lakòs ngamon e njomë. Pse stria jote bredh ture më prier gjishtin mbrënda? Ngë kish t’i kisha dhënë bes magarivet të botës, edhe sepse jam i pakëzuar e marritë tim premtuan përpara priftit se do të kisha helqur dorin ka gjithë magarit të botës. Do të kish sosur të kisha qën i krishter i mir...”

“Priftravet ng’i ka bes mosnjeri. Na kem’ t’i kemi bes të mbëdenjëvet e më të madhit e gjithve: Silenit, çë përsëritin Jobin. E ti çë djovasin libret di cilët jan tjetër: më mir për njeriun mos t’u kish ler. E pi një qelq verë?”.

Thërret gruan rromene ç’e ndifmom e i urdhuron të marr verin.

“Jatroj thot se ngë kam të pi, po ngë mejton se jam një i mbijetuar i kujit ng’i mburton ndose nesor ngë zgjofet më. Si thot ai i madhi i Dostoevskit: dyzet vjeç jan shum për njeriun. Ki vulim i jatronjëvet se kem’ të mbijetomi është frymë e madhe kundër Perëndis e kundër natyrës çë na deshtin pjot kufinje e të pafuqishëm”.

Sosin ka fjalët. Pra ngrën një gjisht:

“Vetim Ai gjellon... o e harrove Kohelletin e dashur?... Pra jemi ndër duart e këtyrve të huajë”.

Na e rrën një grua e lartë e bjonde me fityren e huaj, me një spazë me dy qelqe e butilin me verë.

“Po sot ngë mund kamaromi, është e prëmtja e shëjte” i përgjegjem u çë ngë pi më ka shum. Di se nëng mund t’helq dorin për ligjen e mirpritjes, po dhon Fernandi di si ka të më shpëtonj ka ngushtja.

“Bë si të duash, biri im. Ngë kam më gjë të të ofronj. Po hujtimet e javës së madhe duan shejteruar. Po me një kafë nëng kamaron. Edhë priftrat kush e di sa kafenje duan të pin sot”.

Pranonj një kafë, kështu mirpritj’e arbëreshëvevet ë e shpëtuar.

Gruaja lë spazin, e e qetme si erdh ashtu ikin te kuçina.

“Jan gra më të holla se tonat. Tonat kan turrendë kushallët. Ngë ke si të komandosh mosnjeri sot. Asedhë ato çë një herë qelnje ndër vreshtat sa t’i jinje gjë për me ngrën. Të sulen me arkanxje. Këto të

huaja kam besë se ng'është nevoja ç'i bën të buta. Sikur se kan njetër ndjemje me t'afërmin. Jan gratë arbëreshe që jan pjot rrunganxje. Si do t'jetë e lumëta jot'ëmë që di e gjellon e vetme. U ngë di e tiganisinj një ve”

Kur fjet ngë më ruan ndër sy, vazhdon e ruan zjarrin me kryet ulët. Ka jetr'anë ngë e fjet me mua. Vaxhdon një solilokjum që zu kush e di kur.

Po ng'i shpëton ironia e ture ruajtur zjarrin i dhezët ket ajo vatër e madhe rrethë së cilës na jip mësimet e filozofisë gjatë dimre të ligjë, pjot erë e pjot kamnua, ngrën si ngamon qelqin me verë: “Na ngë kemi di perëndi kuj t'i sakrifikomi, asedhë një vetem. Qindruam të vetëm. Vëlim'i virtetjes bën e ruami vet kët zjarr që na djeg pa ngushulim e pa sprënxë. Na mungoj edhé artja që thon se na ndifin të vemi mbatanë realitetit që na varesin e na dorrokopsin... Nëng dim'e bëmi, sidomos na arbëreshë, më verin. Na qindroj vet uthulla, që kem' të pimi njera ket fecë. Ke ligjë, sot ë e prëmtja e shëjte, kem të pimi vet fecë”.

Na e rrën gruaja me kafeun. Përfitonj të ngrëfem e të vete ket dritësoria sa të shof si vete shiu. Ruanj për së llargu figurin e këtij mjeshtri që më mbjodhi pra ç'ika ka kulexhi. Ka të ketë tre o katër vitra më pak se mëma. Edhë ai u firasë si një dri e moçme. Karicon nanë maçen ç'ju vu më sjet.

“Na qindroj vet dhëmbësia për nga gjë. Sidomos për një maçë, që ngë pat ngushllimin e artës. Ngë kemi ndrishe mestier se të psomi pa ngushllime gjellen që na ngau, po që fati ngë na muar sa ninga u lem. Nietzsche pat fatin të mos të mbjakej”.

Më priret pra i padhuruashëm: “Kim lipisi, u të ftova më shpit time e jam e të varesinj me llafet time”.

“Jo, mos u mbjak zotrote”, i përgjegjem pa bindje, “jam ngamon i kënaqur të gjegjinj strinë tënde e të xë gjë. Zotrote qindron nga mot mjeshtri im më i madhi”.

“Jo u bëre ti mjeshtër, pa lënsit time. E pra që mund thon dy t'urtë si na? Vet shertime mbë situatën e njeriut”. E ture m'u sulur: “Ti, më duket se u bëre si kalor'i Dürer-it që shkon fare i helmuar midhis mortjes e djallit e ture ruajtur për së llargu se si *Melancolia* e tij, indiferent gjithve magarivet që njeriu piksi sa të duronj situatën

tragjik e tij. Mua më qindroj vet vera....e nanì ngrënj qelqin gjithë perëndivet që banojin ket kjo vatër”.

Di që është e citon nani: sa herë i ultë prëzë vatrës na rrufiejtë anekdotin e t’ “errtit Eraklit” kujit, si thonei dhon Fernandi, i sosnej polica t’ish më i urti.

Pikat e verës që bien ket prusha fërgojin me një rrëkim të shkurtër.

Dhon Fernandit ng’i ikin kazjuna të ver ket kujtimet e tij profesori me zërin të ndrequr si ai i njëj prifti mbë altar: “E se sa më jini ju perëndi ket kjo vatër ënëna bukurinë e shpirtit e bëni të kemi ndë kushall aqë të holla se sa mund’ të qellinj një i urt”. Pra i prierrë ka u: “U bëre shumë i bëgat? Se sa vreshta mbolle e se sa shpi stise e sa gra mbjodhe ket një harem? E vure profume ket lesht tënd rrushkull? E veshe stoli të bardha për të ngushullonje helmit tëndë?”

“U jam i vapëk” – i përgjegjem pjetë turpë.

“Ti qeve i bëgat. Pate Jurendinën, më e bukura grua që Ynzot piksi. O mejton se e harrova? E sot ke njetër Jurendinë: ke bukurinë e shpirtit, ke lehtësinë e shpirtit. Për këtë thua mir se je i vapëk. Ti praktikove *melete thanatou* si filozof i zgjedhur. E nanì që do të bënje: të shpëtonje ka angthi? Kush bëgatin shpirtin madhëson angëthin. Gjithsej t’u pruar kundër. Embëlsitë u bën të thartuara. Ç’i që Jurendinës? *Eloi Eloi lama sabaktani*. Si priret drejt fjala”

“Ka hin Jurendina?”

“Hin, hin Jurendina. Ish një koqe rrushi pjetë lëng. E di kush pat fatin t’e ngjepsënej. Jurendina ish si Nietzsche. Doj marr me dozin të drejtë për mos të të farmakosnej. E jatroj diti që beri kur tha për tij: sosin me Jurendinin”.

“Ka hin nanì Jurendina? U mbjak”.

“Kjo që u mbjak nëng eksistoj kurr. U jam e thom atë Jurendin që piksi deshiri ynë. Që një perëndi na vu përpara syvet sa të durojim situatën tënjë tragjike. E pra mba mend: Jurendina ngë priret kurr. Një i huaj e mban largu. Këtu Nietzsche ngë ka ligjë”.

Qindronj i babartur ka ki diskurs i Jurendinës, që thot e ngë thot. E më vjen një sospjekt, po mosnjeri di se dhon Fernandi pat kurr gra e më e më Jurendinën. Po gjithësej mund t’jetë.

Po më nxier ka mejtimet ture thën me syt të fiksur ket zjarri: “Ng’ë sot e prëmtja? Ng’ kem’ të kamaromi asedhë me mejtimin. E na

mund t'jet se kamaruam. Tham shum. Do të kishim mbetur qetë, për respekt misterit që na fashqon. Po mund t'jetë se tham mir pse shtum vet shertime”.

Ture ikur ka shpi'e Don Fernandit kariconj dorëzin e grikës së fytyrës luani që trokullisjim kur ishim të vegil sa të na mirr prapa e jëma. I kam zili asaj moshje. Mund t'jetë se ahirna kishim lehtësinë e lirinë e shpirtit. Ahirna kishim, pa dyshim, bukurinë. Liria, bukuria, lehtësia ç'erdhëtin pra nëng kan paftesjen që kishin ahirna, për këtë ng'jan lirë, bukurë, lehtësi. Ng'është urtësi, ng'është dijturë që mund të të japë paftesjen. Kur u rrite, që xë ndërgegjen e vetëhes sate, del për nga mot ka parrajsi. Zë ajo luftje me të jetrin për t'jesh zot o sherbëtor, që të qellin të biersh paftesjen ket të rremet, taktika për zotërimin të jetës. Gënjimi është mëkat'i par që t'jep përstypien e mundësisë. Gënjimi të t'helq ket deshër'i dijturis. Dijturia të shkatarron paftesjen...

“Kush ngë bëfet i vogil...”

Ajo moshë nëng priret më, me gjithë vullimin e mirvullim që do të kemi. Përkundrazi, është dreq vullimi, e më i keq mirvullimi, që shkatarron nga gjë. Fjalët e dhon Fernandit më thartësojin: u i lirë, u me bukurinë e shpirtit?... jam i shtrëmbët si nj'udrë...

Prier syt ket shpit e asaj gjitonije ket u rrita.

Gjithë dritësoret jan të mblitura, shënim se mos njeri i banon.

Ket shpi'e Kallogres, ket kisha luajtur tanget më të bukur ket rinia pjotë dritë, teku dhezshin hilneret t'artë, kishin bën folen jo vet dallandishet, po edhe pëllumbat, që vejin e vijin ka finestrat pa vitiriatat me një fjeturim i pirtesur. Natën thoj dhon Fernandi se e banojin kukuvit. Pëllese që mos njeri do të ndreqinj, pse gjithë duan shpin e re.

Gurë të hinjët teku banuan për pesqind vjeç arbëreshë që nëng kishin, kam bes, as helmët e manit e dhon Fernandit as timet.

Gjindë që shkuan ditat e tire pa mejtime, pa kujdhese që doj të vejin mbatan nevojat e nga ditje, me të njëjtin shqetësim, ultësisht natyror,

të mbjojin sarua sënduqe me grur, djath, e bukë, bute me verë; të rritjin një derr... të kënaqurë të festavet ket defshin pa dijtur pse...

Pra ja ru dhon Fernandi, pra ja rura u ket kjo gjitonì. Na dimi pse defemi, dimi pse duami grat, pse është më mir të biresh prapa librevet... e se si do marr Jurendina...

Gurët të hinjë më ruajin me rreptësi me vapkësin e tire... u bën serjozë me gjithë dhëmbjet që duruan... kam bes se mbrënda atyrve ng'u le mosnjë që diti të thoj: "jam'e vete ndë varrit ture qesur pse këtu ngë gjeta fare gjë për me marr me rëndësi".

*** **

Si do mëma, vete më qishë. Çuditem se më lagen syt ture gjegjur këndimet grekisht.

Herë e herë më nget se këndonj: "Fos ilaròn". Më hin më zëmir një mallinkonì e madhe, pa një kujtim i përpiktë. Këndonj e fare gjë më shkon ka kriet. Mund t'jetë se është vet një vajtim për një mot që vdiqë për gjithëmon. Mund t'jetë se këta vajtime jan të ngjitur fytyrve që ng'jan më. Mund jetë se jan të lidhur besës se moti ngë do të kish të shkonej kurr. E moti shkoj e këta këndime jan mbetja e të skuames që ngë do të shkonej kurr. E kaluara priret si fantasm e na lipin gjak për të priret për të gjellonj akoma, për këtë na vë mallinkonin e zezë kalosh. Një griepësh te ku vargarismi vetëhen tënë sa mos t'e ndukinj hon'i pafund të gjelles... ka ligjë Nietzsche? Mund t'jetë...

Ndukinj livandin e aromet që zoti shprishin mbë varrin e Krishtit. Ndë mes të gjindjes shof Frangjisen.

Frangjiska....

Frangjiska me tha, një herë me një fill vuxhje që birej ket një frym'e hollë: "Mos ec më tutje se një puthje".

Ruanej më trual me sy t'egër, fort singuar me llapsin të zezë. Dridhej e tërë. Ngë kish ndrishe shenje gjellje.

Me një shertim i lezë i lezë lëshofej ndër krafet tim.

"Mos më ndoh" thonej.

Luajtim, pra, shum tange.

Ishe edhè Frangjiska e hollë, e likshtë. I ngjitej mir kurmit tim ndomos se ish më e ultë. Lënej t’e qelnja si muzika doj, hap pas hapi, rreth rreth ket odha pjot drit.

Na ruajin, kështu të lidhur, me zili tjerët, kur gravet ngë mund t’i ngisnje një gjisht.

Po na vejim të lezë, pa mendje, pa kufi, të bjerrë prapa muzikës.

Kur Frangjiska lodej shtifej ket sexha e shertonej: “Aqë doj të humbsha”.

Prapa një muzikë kish zën ajo lidhje.

Gjatë një mësim grekishtje, kur e ndifnja për diplomën, u kish mbllitur ket një mungim i fort me kryet ultë, me lotë ndër sy. Pra u kish ngrëjtur e kish ikur ture lën t’i binej më truall një bilet tek u kish shkruajtur: “Të dua”.

Isha i ri ahirna, një zet e pes vjeç, tre o katër më i madhë se Frangjiska, mund të birsha prapa asaj, mjeshtër. Jurendina, dhjet vieç më e madhe se u, më kish bën burr kur kisha gjashtmbëdhjet, po më kish lën pjot deshire që nanë Frangjiska vin’e ngushllonej.

Edhè Frangjiska u mbjak e u majë. Këndon pa bindje : “*sono stati i miei peccati*” ket prixhisjuna me Krishtin të vdekur.

Gjegjet më e fort se gjithë vuxh’e Jurendinës.

Ndomos se moti ngë hapu, zoti ngë holqi dorin.

E grat sa më të këndojin grekisht lavdin e t’Ynzoti e misterin e *synkatabasis* e tij me gjithë teologjin e veshtir ç’ ata tropare thon, ven litisht ture vën ndë mes të mëkatët e tyre. Mëket për me qeshur që merituan vdeqjen e Perëndis? Fare gjë mund të lidhinj Perëndin. Fare gjë mund t’e detyronj, më pak se gjithë meketët e njeriut.

Jan kryelartë këta mëket, e kush i bën, për të meritojin kaq.

Edhë pa mëket Krishti do t’u kish njerzuar, thon disa.

U njerzua e desh të zgjidh fatin më të ligë që mund t’i ngas njeriut. Pse do t’ish njeri njera ket fundi, njeriu më i bjerrë, më i humbur: vet kush biret jeton. “U jam gjella” tha. E gjella këtu është sa më pak, aqë sa Perëndia është më shumë, që njeriu mund të meitonj.... Krishti me mortjen e tij ngjiti këta dy matje... mund t’jet...

Po gjella është kjo barrë e rëndë, pa senx, pjotë angëthe, ka e cili do të të shkrakonj një Perëndi që të mëson t’ecish mbi ujit pra ç’u bëre i

lirë ka gjithë të vlerët e kësaj jetje. Për këtë e vran: ish'e i nxir përposh këmbëvet gjithë sigurit. Për këtë e vrasjin ture harruar se ket pakëzimi nga një premëton të shpëtonj ka bota e ka magarit e saja e para të cilavet është se kjo botë është drejtë se si xum se është...

Çë mëket ka bën Frangjiska, kjo Frangjiskë çë nani qellin pa ulur syt mishin e saj t.ë majim e të shuajtur ket kjo prishisiun pa bindje? E çë mekate ka bën Jurendina, mëmë bilash të bukura, të cilat bën bila të bukura, si ajo kur ish e bukurë për kundin e njëj perëndije çë do se vet gjella ka të jetonj? Ajo thoj "Digëlisim". Shum pak për të shtiesh një Perëndi ket varri, pra ç'e vargarise ket një kryqe.

Sot për mos të kamaronja hëngra shtridëlat e mëmës pa ngulli, një grep. Ngë piva verë, ngë hëngra mish, për mos të burthonja sa i huaj u bëra. Për të njëjten ndjetë jam këtë prishisjuna.

I dhe dorën Frangjiskës. Edhë e putha.

"Çë novë. *Biatu chi ti vidi*" më sulet.

Edhë Frangjiska ë mëmë bilash. Mund t'jetë se ato bila ulëjin syt pjot turpë si e jëma, mund t'jetë se si e jëma i besofen ndër krafët njeriu i trubuluar, i babartur, pa ngrëjtur një gjisht, si të qëlluame, ture zeksur të lumëtin mbë radhë.

Ndërroj zeks Frangjiska. Është pjot senxë. U bë e bindur të gjithë magarivet të botës. Dreq si merikane...

E mbllijtur ket bot' e saj mimarin atë mortje çë nganjë deshiron pa ditur. Ket sigurit. E qendruar ket vetëhea e saj.

Më rrëfien entusjastë, ture lën këndimet e litinjëvet, sa dhera, sa shpi bjejt i shoqi ndë Merkët. Frangjiska u pruar ka Merka pjotë unaza ndër gjishtrat. Fshefin syt, të vegjil si malë gilpërje, ndë mes të dy kokazë të fryrë si paneta, prapa uqelë të mbdenjë pjotë lila. E trashë, si gjithë ata çë priren ka Merka.

Pështoj ka mësimet tim.

Ngë desh të dij honesh: "*la vita ng'ë poesia*" thot. I pat kujdhes gjelles e saj. Gjet botën e ngurtë së cilis sosin t'i përgjegjesh se dishirimet bëfen të vërtet. Kush e di ndose Frangjiska, çë thot shumë të vërtetjetë të vlera, di e luan akoma.

"Do të humbesh ankora?". Me një buzqeshje marrëveshje më bën britë. Ka mbëshetjet nani. Kët herë ulënj u kryet i turpëshëm: ngë

bjejta dhera, ngë bjejta shpi, ng'u martova, ngë bëra bilë. Mund t'jetë se u bora ndë mes të shumë tradhëtime. U façova përsipër shumë hone.

Fjalët e gjest'i Frangjiskës më përshkojin ture më lën i taraksur. Vrenj për së llargu Dhimitren e mbështëtur ket nj'angon shpije ture vrejtur prixhisjunin pa kujdhes si gjithë të rinjët.

E përshëndet ture tundur dorin.

Ajo m'e rrën: "Çë je bën këtu".

"Detirin".

I qasem ket veshi: "Ke ligjë ti, mos u martò e mos u majë".

Më shtringon dorin.

I qeshjin syt, ture shkëlqier ket drit'e natës.

Ngjatet e më shtie një puthje te faqja: "T' haristonj".

Simbjet erdhëtin shumë turista për javin e madhe. Këta të huaj, pa qën të huaj, ngë zën rrëçet mos gjikùn, e të rraxhuar ven ture qellur këtu e këtjé paraqënëjen e sigurtë e tyre pa turpë.

Zoti është i kënaqur se i erdhëtin shumë të këtyre të bekuar çë din e fitojin botën, drej si urdhëroj Perëndia.

Njetër vrundull entusjasmë më jep një marr mendje.

Për të burthofem dakord me zotin, bënj çerin e piçuçit e i thom se katundi meriton gjithë këta litinjë. Kush e di ndose erdhëtin për Krishtin ose për çerimonit ose për të shkojin motin se si ata çë kan të shpëtojin ka kujtim'i mortjes se si thot Pascal: për *divertissement*. Kush e di ndose xun t'ecjin mbi ujit... kristherë të rremë çë tradhtuan jo vetim premtimet e pakëzimit, po ju shtum me gjithë zëmër ndër krafet e magarivet të botës...

Çë vet'e vë në kufi?

Nani çë prixhisjuna firmoj, u hap qielli.

Një henë e lajturë bën e shkëlqen terracin të lagët.

Nani ka çimineret kamnoj hipet më i paqëm, i zbardhur ka drit'e hënës.

Ndër yllët burthofet vet pramenda e madhe.

Ka Sybari duken gjithë dritat çë rrethojnë detin çë shkëlqen përposh hënës.

Hëna ë zonzjë sonde.

Është e njëjta, kështu duket, që ng'u mbjak e rri më qiell pa kufi, pa dishire, e varur ket një honë pa fund.

E ruanj, e më ruan, pa turpë.

Nëng qe ajo e qellur më para ndër vreshtat o ndër vallet të veshej me stolit e bukurisë se pra t'ish e xheshur e e lën ka gjithshorçit, e qellur dhunë, e vargarisur midhis dhëmbjet e saj. Ajo u bë e huajë par se të bëfej e huajë, vdiq më par vdekjes, pa kujdhese pa mejtime pa kufi.

Nani ri paraqitje e thjeshtë ndë mes të qiellit.

Adunarem, po, se kjo vdekje par vdekjes, ki pakufi, ki pakujdhës, jan njetër siguri.

Çë më magjepsjin, jo më pak se sigurit e Frangjiskës.

Gjalpri zë bishtin, si kulaç'i Pashkëvet.

Kam të marr frymë e të çfrynj thellë ture u vën kocaposhta, si më mësoj një mjeshtër, për të këputinj tërkuzin e mejtimevet, e të kujtimevet që më përshkuan si nj'ëndër mendjen...

Një puhë e holle hipet ka deti.

Hinj ket errësi'e madhe e shufet edhe hëna. Dhezet vallj'e Dhimitres që do të ver mbatan pamjevet të botës, mbatan sigurit e s'jëmës...

Menat ngë do të zgjidhen kumbort ndë mes të aromës së dhafnis?

Mund t'jetë, mund t'jetë...

Gjithënjëherje u gjegj sirena e ambulaxës e një thërritje e ligë: U vargarisë Dhimitrja.

Gruaja ime

Ἰδοὺ ὁσμή
(Genesis 27,27)

Dhezi sigaretin. Holqi fort, e pra ndërsa kamnoj i dil ka hunda, zu fill e rrëfyejti:

“E dinë gjithë se gruan time e rrëmbeva. Ahirna mund të më kishin prerë edhë kocin. Ng’ë si sot çë jan të gjitha lleka.

Gruaja ime ish e butë e butë. Vrenej ngamon më truall. E kur i fjisnje bëfej e tërë e kuqe.

- Ng’e ke gjufin të përgjegjesh kur të fasjin?

Dukej e egër, po kish sytë shum t’ëmbël për t’ish e egër edhe për mbrënda. Si kle kle, më zu një oreks i madhë: kish’ t’i puthnja atë buzë të hollë si një pjasje dhe e bardhë sikur se këtë gjaku ng’i shkonej, e kish t’i ngishnja atë likurë ç’i fashqonej sa mënxitë kurmin të hollë si një kallmë. E krafët; kisha një shtipje të çuditur, se do t’ja kisha çare ndose do t’ e kisha shtringuar më se sa sosnej. E vithezit doj t’i kisha ngar, atò vithez, të shëndoshta, ket një kurm çë dukej i tërë pa shëndet.

Ndërkaq hipej si një burrë te shkalla kur mbjidh ullinj të e ngrënej vallunet pjetë rrush sikur se ju kish piksur më kurm fuqia e dhjetë burrave.

Ndër të vjël at kur me kazjunin t’i ndifnja të ngrënej vallunet për t’ja ngrakonej gadhiurit, një ndër punëtorët më tha: “Shi’ ka ke të vesh, ng’ë viskot për dhëmbët tëndë e pra do të të mbitinjë cunjet. Ë e bilë patruni, ty je vet një furiz.

Shkonja i vetëm mbrëmanet e mia, ture e marrë vet ket mendja ime, e lënja ujërat tim të vejnin si ujë muzkje ture përsëritur i llavë ëmrin e saj. I puthnja vithezit...

Një ditë ç’u përpoqëtim ajo sipër gërshisë u poshta, uli syt mbi mua e pa thënë një fjalë duroj shikimin tim pa, si dukej, trëmbësi.

I the se i dukëshin shalët: - Ngë ke turp t’i burthosh shalët njëj burri? Ngë ke turp se u rri këtu përposh?

Ng’u përgjegj, e vaxhdoj të mbjidhë pemët pa u babartur e ture zgjiruar shalët për të arrënej një degë më e lart.

U babarta u çë rrinj'e ruaja ndose ja arrënej njeri e sidomos i jati o e jëma o i vëllai ç'ish më i egri se gjithë në fëmilë.

E zura e përçolla vakand me grikën e thatë për gjithë shqetësimin çë më vënej kurm atà mishë të bardhë çë shikonja.

- Shi' se u ngë tundem ka këtu e kur të zdropesh ka gërshia do të të marr. Ti je më vë më kurm një oreks të math.

Ng'u përgjegj as u tund ka dega tek u kish hapur shalët të rrinej n'ekuilibër. -Ngë ke gjufë të përgjegjesh, shi' se u vazhdonj e të ruanjë e kur do të zdropesh u të vë duart kalosh.

Duart e saj vazhdojin e mbjidhjin gërshi. Nga çik lënej të bijin disa veshë. U kisha bën i tërë lucë e ngë do kisha ditur të thoja cilët ujë më lagnej.

Më shpëtoj ka situata delari ç'ish e shkonej me mëndrin.

-Guanjù, ng'u adunarte se kjo ë e pjekur?

Kur ajo pa delarin vu vestin anamesa shalvet e zu fill të zdripej ka gërshia.

-Thuaja një fjalë këtij xhuvinoti - qeshi çobani.

Ajo u anangas me panaren pjot gërshì e turë u burrartur j'arru ket kazini ket ish'e përgatitjin të ngrënit e të korravet: qepë, ullinjë, ruvdata, përsut...

Aso ditje ngë hëngra, ndifsha i ngosur.

- Shi' se ti e merr ndë bithët e vdes - më përqeshnej gruaja e delmjerit - Ky trimë do të bëfet nga dita më i likshtë e do t'e marrë ndë llunjët.

Përqeshja e gjithëve me bëri më të rrëziktar: kish t'ish imja, kish t'i burthonja gjithëve sa vlena, dreq me një grua çë ngë kish si t'ish imja.

J'arru më gusht rasta.

Përposh shkandrisë më të madhe. Kur gjithë fjëjin mezditë.

Ish ditë pjot cinxra. Ahirna ishin cinxra pa kufi. Nani çë dorrokopstim gjithë dherat, se kish të stisjim shpì, u llarguan ka katundi cinxrat e dallandishet. Vera është ngamon më e qetme, ngë llarisin fare gjë. E ti e di ç'është një kacamite? U bët gjithë gjeometre e nga një desh të stisnej shpitë e tija sa të mbjonej me të holla bankat. Kini nga një tri makna e për tri makna hëngëtët gjithë petkun.

E di. Edhë u bëra këtë gabim të madhë, edhë u i vura këtë halë ket goj'e katundit. Po u kisha një pretekst. U kisha lerë ket nje katoq te ku mbjdhëshim si kafsha e fjetim njeri sipër tjetrit.

Ahirna ishin hardhla mbi muretet, arvuret pjot cinxra.

E sa të gjegjënej cinxrat ajo çomë kish vatur ndër dherat. Dielli i poqi kocin dhe e zu një marmendje e madhe.

E gjeta ndë mes të kallamevet të fiqur. M'u duk e vdekur. E mora ngrah e ja qella s'jëmës.

- Nga, nga, ec mirr ujë të ngrit. Lag një cinxullë e sillme.

Ndërsa venja ture gjetur cinxullë e ujë frisku e jëma e kish ngjatur më shtrat e i kish nxierrë vestin kalosh. Ish e tërë e lagët djersësh. Për shkandrin e për ethen dridhej e tërë. E për sëmundjen nanë e jëma m'e ftonej për likurë vet me zlipin. E desha ndutu më shumë kështu e sëmurë dhe e vdekur si ish.

U ngordha i tër. Zura e dirsita edhë u. Më zu edhë mua një marmendje, ndërsa lagënja tirqit.

- Je m'e jep atë cinxullë, ç' je pret sa të vdesë?

E jëma zu fill e i shkoj cinxullin ndër ballë, ndër shalë.

Një e sëmurë ng'ë më një grua, as në virgjir çë ngë do parë. Si një jatrua mund t'i kish vënë duart kalosh pa trumbulsì?

Ndërsa e ruanja pata zilë për sëmundjen e saj. Do t'e kisha pasur ngamon e sëmurë... kështu e papërgjegjëshme...

Mund t'jetë se një dëshirë e tillë ng'ë fare e mirë. Mund t'jetë se edhë u kish t'isha i sëmurë. Po kle ahirna ç' u taksa me vetëhenë time: ka t'jetë imia..."

Më ruanej i vrëjtur ture çfritur kamnua ka hundët, pra ç'e ndukënej gjat gjat ka sigareti.

"Ju çë dini. Ju e shtut si lëng pjënsi. Ng'u lodhtit për fare gjë. Gratë ju i sielljin më shtrat prindrat. Gruaja sot u bë shërbesi më i lirë, i më paçmim të botës.

Ka do prire gjën një çë të pretë me shalët të hapta. Na kish t'e dërsijim...

Si do kle. Kle përposh njetër shkandri gushti ç'e pe se vej njetër herë ndër kalamet. Kisha bes se doj t'j'arrënej mënevet çë nxijin me korronxezë.

- Leji të rrin korronxezët. Mos kam të vinj njetër herë të të marr kur do të të vilakosinj vapa? Ea hir, ea rri më hjë...

Sikur t'e kisha tëhelqur me kush e di të cilin mjaltë, la udhën e korronxezëvet e u drejtua ka kaliva e delarit. Më ruanej si e magjepsur. E dyta herë çë më mbanej sytë kalosh. Po i uli mbjatu. E një dridhëm i skundi kurmin.

- Je njetër herë pjot djersë. E di se ndose bier ujë me djersët mund të të zërë gjë?

Nxuar mbjatu mbrolat kalosh e qindroj vet me zlipin: e ti bëm si mëma. Lagim me ujë frisku.

Qindrova palivizur si një shtatull. Ruanja pabesim shfaqjen çë më paraqitej përpara. Kur e kisha par të parën herë ndër duart e s'jëmës i turpëshim llargonja sytë, ng'i kisha vën shumë rë kurmit të saj.

I ruanja nanì këmbët me gjishtë të vegjil e të kërrust si marroca sipër një fill bari. Shalët rrubullaqe rrëjirëjin një mes çë hapej si një spaz me mushkulet e barkut të sheshët.

Këtjè çera ime mund të birej.

Trungu ish i vogël ndaj rrëjestin e kurmit, sidomos ndaj shalët rumbullaqe e të forta. Dy sisë të vogla ... - ngë më pilqíen kurrë grat me shumë sisë: sa më sisë kan më çoma jan...

- Do se kam të të shpjeksinj leshtë?

Një fill vuxhje më zgjoj ka magjepsja çë më kish marrë.

- Ngjatu ket lliterj'e delarit se të luginj.

Kisha marrë një hjiropane ka shkallandrini dhe e kisha lagur ket ujët e karroqes.

- Ti do ruajtur mëparë.

- Çë ke të ruash? Bë nga, do se ka t'j'arrënj njerì?

- Do t'e bëmi një lozje? Vëru ket kakava se të luginj me pompin.

- Shi çë ke të bësh, e anagasu, le të rrinë çotaritë ...

Përgjunjaz sipër kurmin e saj zura e e lajta si e kish bën e jëma.

Pra zura e i lëpijta barkun.

Dukej si një shtjerrë gati për t'ish i thertur.

La t'i hapnja shalët. E më zu nj'oreks i math, sesì do t'i zër njëj ulku kur ndien erin e gjakut.

Ish e ngrohtë dhe e lagët. Cili është ki mërakull që të bën e dishëron të spavesh...?

*** **

Shkuma e birrës u kish e tërë e spavur. Ngrëjti qelqin dhe e piu me gjithë një frymë. Teri buzin me kurrizin e dorës.

Na thomi, thomi, po që thomi? Vet fantazme. Vet tringëlle fjalësh. Ti thua po po me kryet. Po sesì mund të dish atë që ngjepsa u? E ndomos se e mbajta me mua, ngë ngjepsa më, me atë grua, atë që ngjepsa ahirna.

Kle nëma ime, ajò e para herë. I këcenja nga mbrëma ture kërkuar pashpresisht atë vëlim mortje e së parës herje.

Bën e më bëri vet shumë fëmilë po jam akoma fatkeqsisht i gjallë e i zjuar... edhë ajo mund t'jetë se kërkonej atë dejmje të së parës herë, pse ngë më thoj kurrë se jo, kundraz ish ajò që shpesh më tëhilq e pra hapej me nj'orekës të madh. Pra për gjithë ditën më vrenej e egër e me urrejtje...

U bëm të hinjët, u trishtuam ture kërkuar të përsëritjim... kë?

E na mbajti, na lidhi, na pengojë dimri i pakënaqësisë sonë.

*** **

Kisha harruar të të thoja sesì e rrëmbeva.

- E nanì? i thoja u, pra ç'iu mbraza mbrënda, nanì si bëmi?

- Shtiri sallaçin derësë. Më tha ajo e paqëme.

Pra muar hiropanen. Teri gjakun ç'i ndotenej shalët.

- Za vëre ket dritësorja si një fjamur e fitimit tënd. E mos u llavë. Ea se mirremi njetër herë.

E zu një muzike e hollë e fortë, e ashpër dhe e ëmbël që na dejeti për ngë di sa mot.

- Priru, thërrisnja, kam të të puthinjë kokazit e bithës.

E ajo: Ea ea ea, kështù kështù kështù

Njeriu i ka turp kurmit, u ja bekova të tërë gruajes simë, për këtë mund të të rrëfinj atë që do të duash.

Po rrëfienj edhe pse kam të ndëlgonj pse kle gjithë një mashtrim. E ndose Perëndia ngë na nganonej...? po qoftë i bekuar e doksa qoftë e tërë e tija...

Kur pra u xu ku ishim të fëshefur e çë vjen me thën ajo hjiropane e ndotët me gjak, i jati zu e thërriti: Veni ju ka zoti o kam t'ju e siellë këtë...

Çeli njetër sigaret. Ruanej llargu mbatan limtin e gërshivet:

- Pse rrufiemi? Jemi piçuçra e përdhuçëra. Ngë dimi e bëfemi të bindur se gjithësej shkon. Ngë jemi të bindur se gënjemja është pse na jemi si kikllikiu i natyrës e lozja e perëndivet.

Rrëfiemi se të bëfemi të bindur se shurbiset i bëmi na...

“Je vjenëëëëëë” ajo thërritje ish si nj’ulurim çë cakosnej qetësin e llakavet. Ahirna banojim ket kazin’i vreshtës. Lënja të tjet puntorë ndë mes të udrivet e hipsha ka kazini. E dinja çë më prit. Ndomos se e lodhënja e më lodhënej, më kanosej: Çë të zë? Ng’je më i mirë?

- Pse ti si je, je e mirë? Di e bën më si të parën herë
- Ngë të pëlqenj më. Mos vete edhe ti ka Betina?
- E ti ka vete?
- Qellëm rispjet, delar - vrëhej ajo.

E rrëmbenja njetër herë me tërbim, me furi. E nga herë gjimtomej gjë.

Ngë je më i mirë.

Ngë je më e mirë.

Ti bilaruç ke të dish se fare gjë priret.

E zu e këndoj: Ku vate moti/ çë ish më njëhere.

Gruaja ime? Ngë më denej më.

U qet njetër herë. Muar qelqin e nduki njetër kloq birra.

Do t’e dish vërtetjen? - zu fill – kish ligj masar Xhamatista.

Një herë, ndërsa i kishim kujdhes mëndris – kishim jacin ndër mbersat e Shimremalit – kish zën një shi i madh e vam e u rëkutëtim ket kalivja. Ahirna mbaroj qetësia jonë, zum fill disa diskurse, e si qe e si nëng qe Xhamatista më piejti:

“Po ti i kërcen akoma sat soqje?”

“Pse ti jo?”

“Janë shurbise për të rinjtë. Po pra çë bëre një ose dy bilë, sesi mund t’i këcesh së jëmës e tu bilëve? Ësht sikurse do t’i këcesh mishit tënd. Mban mend kur vure kurorë si thoj prifti? Do të jini një mish i vetëm”.

Këputi rrifimin.

“Putër’e të ligut. Kish ligj Xhamatista. Pas tre bila sesi mund t’i kërcenja s’e jëmës e time bilave? Zura fill çë ahirna t’i vënja kufi adurit të kurmit të saj. Kish adurin e sime bilje, së parës e cila fort i gjit s’jëmës në gjthësej. Po qe ki akund çë më trubulloj trutë. Njëherë ç’i kërcenja sime shoqe pata shtipjen se ish’e i kërcenja sime bilë. Ahirna e desha me një tërbim të madh. Kur mbarova, u shqita ka kurm’i sime shoqe me një zding të madh. Po çë ng’i volla kalosh.

Ajo tundej e kënaqur më shtrat: “Cili shëjt të bëri mrakullin”.

Mrakullin e kish bën ime bilë.

E çë ahirna ng’e ngava më time shoqe.

Kish’ të kisha vat me ndrishe gra? Me Betinin si thoj ajo? Po u ngë donja një grua si do të ndodhej. U donja gruan time. Atë çë kisha vreitur e bardhë pirposh gërshisë.

NJË NGJITJE TE MALI

Kur ja arrum ka “Vër’e avullit” e pa brinjin e madhe, Tereza tha: “Perchè non saliamo di qua?”. I the se dheu ng’ish i ngurtë e se përposh barit kish vet shurë pak të qëndrueshme.

Tereza ngë desh të dij faregjë, vrenej atë brinjë e doj të hipej, si hipej ket shkëmbet e Piemontit.

I the Turit: ”Ti si thua? Ësht shurbes për m’e bën?”

Ngrëjti krafët pa thënë fjalë.

“Ti u hipe ndonjëherë këtej?”.

“U kur isha i ri e vinja këtej me mëndrin shkonja drejt pse këtu kafsha ngë kish çë të kullotnej. Ngë she’ se janë vetë galire të thajtur”.

Pra ruajti lart ket mbaronej brinja me një kurorë fagarelesh: ”Këtje sipër lefen këpurdhë të mira, ndose gruaja jote do, hipemi këtej kështu j’arrëmi më njize sipër”.

Më kishin thënë se Turi, megithëse kish trizetë e djetë vjeç, hipej mbi brinjat si kacamite.

“Ndose e bën ti, mund t’jetë se ja bënj edhë u” - ju përgjegja me një çik arkancje, u ç’u kisha rritur ket një qitet e venja ndër malet vet për një shtitje pa rrëzike.

Kisha par ndonjëherë Terezin çë hipej ndër shkëmbet, pa trikuza e me duart e xheshura. Ngë kisha dashur kurrë t’i venja prapa. Ulësha ndër këmbët e shkëmbit dhe e prisnja ture djovasur ndonjë libër.

Turi më ruajti këpucët qiteti e u vu e qeshi: ”Kem të qeshmi me ato carithe?”

Ruajta mokasinet tim e i the të dyve: “Ecni, se ju e arrënjë ture u hipur ka karrera anamesa fagjevet, me këtë këpucë ngë kam ku t’ju vinj prapa”.

Tereza, e veshur si ngamon me “fuseau”e carithet si një “free klimber”, kle e para çë zu e u hip, po me vështirësi, pse, si kisha pandefur, dheu shurje zu e i shkau përposh këmbëvet.

Turi e vrenej ture qeshur, pra i dha një vuxhë: "Aspetta a me, signori".

Dha dy kërcime e ja arrù "sinjorinës": "Devi salire di corsa se no scivoli in dietro".

Tereza ndomos se hipej si alpinërat – tri të patundur e një në livizje – kish vështirësi, aq sa Turi kish t'e pritë t'i ndënej dorin për t'e hilqë prëzë 'tij, o e lënej të shkonej, pra i vënej duart ndër bithë sa t'e ndihnej t'ja arrënej ndonjëj rrëmbje me të cili ndihej të hipej.

Kur hita te karrera çë hipej ndë mes të fagjevet ng'i vrejta më, m'iktin ka pamja: ku u kishin humbur?.

U anangasa s'a t'ja arrënja ket çuka par se t'j'arrëjin ata.

Ngjitja edhe për mua, me mokasinet çë kisha mbathur, kle e vështirë e pat' të prisnja sa të zënja frymë.

Kur ja arrura te çuka e brinjës isha i tërë i dirsitur e me zëmrin te goja.

U façova ket brinja: pandefa se Tereza e Turi ja kishin tash arrur ket çuka, pse ng'i shinja mos gjikun.

Dhë një vuxhë. M'u ruar vet ehoa ka të tjerat brinja - e një fishkëllim qifti.

Zura ture përshkuar karrerin i sigurt se Turi e Tereza u kishin drejtuar ka sheshi e klishës së Shën Mëris së Malit

. Nga çik jipnja një vuxhë ture thërritur kur Terezin, kur Turin.

Nga vuxhë, ngamon ehoa - e fiskëllim'i qiftit.

Sa të bënja njize, le karrerin e hita ket dushku, do t'ja kisha arrën më njëhere sheshit e shën Mërisë.

Kur isha po t'jarrënja pe, për së llargu, Terezin prapa njëj fagu. Kish leshtë të shpjeksur e ndreqënej T-shirt-in ture e kallur ndër tirqit. Me duart anangasej të pastronej krafët ka fjetat, ka bartë e ka pjëhut ç' ju kishin ngjitur kalosh. E kuqe ndë çertë, ndërsa hilq tirqët ndër gjunjë, mirr frymë anangast ture thënë: "Mamma mia, mamma mia". U fsheha dhe e le të ndrëqej. Kur j'arrura e piejta: Sei caduta?

"No, sì" u përgjegj e shtoj e babartur: "Turi è andato a funghi".

“Certo che è una freccia, quell’uomo. Una forza della natura. Alla sua età”

“Eh” u përgjegj ajo, ture ruajtur ngamon për trolli e ture shkuar kurrizin e dorës ndër ball.

Asò ditje ngë shtova një fjalë, vam të qetmë te udhët e malit. Këtej e atej vet një tringëllim kumborsh: një mëndër qesh kullotnej ket shesh’i Kampllongut. Më tutjè një mëndër kuelësh, me dy o tri pullelj. E gjithaparë qetsia, çë më mëshonej.

Tereza mbet gjithë ditën si e magjepsur me sytë të kuqë e të lagët. Ngë dita kurrë për kë do të kish qajtur.

Kur j’arrum më katund, desh’ t’iknej: U ngë mund të rri më këtu.

Muar maknin e u nis.

Ç’asò ditje ng’u pam më.

DERA

*Xhesufatit Kaparelli,
Kushllirit tim gjuhsor, një haristim*

U hap dera e hiri një kolpanë erje që shuajti qiriun që dritësonej stanxjen ket ajo ishë ulët prrëzë zjarrit.

”Kush është?” Tha, pa ruajtur ka dera. Ket muri i ngjatej hjea nani që vetëm flakat e zjarrit bëjin dritë. Iu përgjegj qetësia. Po kle një moment. Një shkeptim i fort mbjoi pjot dritë kamaren. Maçja vate u fshef përposh shexhuliqes, me një shërtim të shkurtur.

Njetër moment qetësi; e prapë gjëmoi sikur se ish e i bij shpia e tërë kalosh. Gjëmimi vate ture u bjerrë matulla matulla si ka farnitat, ka Altumunda, njera Sibar. E shtringoi breshri. U hapë njetër herë shkeptimi. E njetër herë i fjandasi se më derë ish njeri.

“Ta, je ti”. I jati ngë mund t’ish, kish vdekur ka ca motë; e i kish vatur prapa edhe e shoqja.

“Më, je ti?”. Iu përgjegj pupani gjëmimi, e breshri që nani ish i hjedhur ka një erë e fort. Zu fill e u batir edhe finestrolla ndë tavullat. Në zjarrë bijin koqe breshri, që ture ziejtur hollë-hollë lëjin pika të zeza ket hitë.

Doj’ t’u kish ngrëjtur të venej ket telfoni të thërrit cien, e cila që kur i kishin vdekur prindët i rrinej akortu. Po njeri ish më der e e ruanej. U stringua me gjunjët më sjet e mbulliti sit. Ndiejti se i lagshin, e një lot iu kalllar ka kokazit e çerës. Mos t’ish mëngu e mir të ngjatënej dorin të mirr qiriun e t’e dhezënej...?

“E’ una lieve isteria. Tipica dell’età”. I kish thën jatroj Kosenxë ket e kish qellur cia për ata diskurse “strani” që e mbesa bënej her’e herë. “Le passerà non appena avrà trovato un bravo ragazzo che le faccia gli occhi dolci. Fatele frequentare qualche coetaneo. Mandatela in discoteca...” Cia doni t’i kish thën jatroit se diskoteka Firmozë..., po i vdiqtin fjalët në gjufë. Po ai Xhusepa... ndomos se ish i madh, ndomos se kish fëmilë. Do të kish dashur Ynë Zot t’i nxir atë mbaç asaj vashzje me kocin pak e sigurtë. Sa dëme

bën mortja...ata dy prindë, njeri prapa jetrit: i kish marrë të dy kangarea. E kjo vashiz pat lënej të venej më skollë, ket, kem' t'e thomi të dreqtin, ngë benej shum beni. Po alminu do të kish mbetur me shokët e prima o poi një dhëndirr do t'e kish gjetur.

Nanì ki Xhusep, ç'u kish mbjedhur ka Xhermania, i vënej një çik turpë: ajò ish një çik kriature, ndomos se kish tetëmbëdhjetë vjeç. Ka i kish ardhur nxe Xhusepës t'i vënej sytë kalosh? Çertu, ndose kish pasur ndinxjun t'e qellnej ndë Xhermaniet do t'e kish nxierr ka katundi e ka gjuftë e ligat, po i bekuari u kish vën me kocin e ngurtë...

Gjegji se njeri e thërrit për ëmri. Shkeptimet kishin firmuar e gjëmimet ndishfin llargu llargu. Edhé breshri i kish lënë llokun shiut, çë nanì binej i hollë i hollë e gjegjëshin vetëm ujërat e llavinavet dhe të kanalletavet.

Gjegji njetër herë ëmrin i qartë, dreqë sikur t'ish Xhusepa kët herë. Mund ish se Xhusepa kish profituar të dritës çë kish ikur t'i hinej më shpì. Po pse kish t'e trëmbënej? Çë motiv kish. Ai ish i zoti të hinej e të dil ka shpia e saj kur të donei.

"Xhusè, je ti?" ng'iu përgjegjë njeri. Ndiejti vetëm si një frymë ç'i frynej ndër vesh. E ëmrin. Ëmri ish i saj. Ëmri. Nj'ëmër të qatrarin. Nj'ëmër të ndan ka gjithshorçit. Kur gjegjin se njeri të thërret, bëfe i vetim, ngë kè ka të fshefesh, do vetëm se t'i përgjegjesh. Për të cilin përgjegjej? Çë donej nanì ki ç'e thërrit për ëmri. Iu duk se ish e para here se njeri e thërrit për ëmri.

Ndiejti se barku i ngrofej. Shtringoi gjunjët me sjet ndutu më shumë. "Çë je më bën" tha ture qajtur. Një kolpanë erje, kët herë ka çiminera, i pruar matualla matulla fumatin. Kollisi pa frymë. Sytë zun fill e i dogjtin. E një dridhim i ftoftë i drodhi kurmin.

"Çë je më bën, çë je më bën?"

Ra ka shexhuliqja e vate më truall. E lefi hollë hollë si një kulish: "U ng'e di ndose dua. U ng'e di ndose dua".

Më vatër shkeptin gobaçet lisi. Maçja u trëmb e vate ture gjetur njetër llok mos t'ia rrëjin ndilat e gobaçevet çë shprisheshin llargu gjith'a paru.

Kur u pruar drita, u gjënd gjatë gjatë më truall. E kish zgjuar vuxh'e televizjunës. Ket një film amerikan dy makna ishin e mirreshin prapa, me një rumurat të madhe. Frigoriferi kish zënë njetër herë të zienej i but i but. Maçja u kish vën kulaç sipër shexhës dhe e ruanej me sytë të krrustë, të dhëmbur ka drita.

Gjinekollogji, ture lajtur duart, me një buzëqeshje të gjatë e të kenaqur, "Cara signora, tha, stia tranquilla: sua nipote è integra. Per il resto non so che dirle, non so se è un bene o un male vivere di fantasia. Sa, i tempi moderni ci chiedono di stare con i piedi per terra. Basta il cinema per sognare, dicono. Per quanto mi riguarda non so che cosa significhi questo. So che tutti sogniamo, anche quando stiamo con i piedi per terra. È una bella allucinazione la realtà. Non so se mi spiego. Per il resto, io torno a consigliarle di portarla al mare. È una bella ragazza, per dinci. A diciot'anni, poi; in che mondo vive?"

Ture u prjerrë Firmozë me autobusin, cia vej ture i thënë : "gje', bëm një pjaxhir, ea e rri ka na. Çë bën vetim ket ajò shpi e madhe? E mos i thuaj gjë njariu. E nanì, si arrëvomi, thuaji gjë Xhusepës. Gjeggjim mua, mund t'jetë se gjënde mir me atë. Ësht një burr pjot senxë".

Më shpi, ket shpia e madhe, ka ngë desh të dilë, pse ish shpi'e prindëvet, u ndie njetër herë me barkun e frytë, i xhirarnej koca, i vin të villnej. E ajò vuxhe ç'e therrit me ëmrin e saj.

Muar kocin ndër duar. Mbulliti vesht e vej ture thën: "çe do ka u, çe do ka u? U kam ndrishe shurbise ndë kocët, lem të vete. Che senso ka tutto questo? Shi' ka ke të vesh, shi' ka ke të vesh. Ng'ë më mot për këto shurbise". Ruajti me sytë pjot lotë telfefonin. Ngrëjti kornetin e bëri numerin e Xhuzepës. Ture pritur se njeri t'i përgjegjej, ndërroi mendje. Uli kornetin e bëri njeter numer e ture qeshur: Mariù, jemi nel duemila? Pse ngë vjen e me merr se vem'e luami? Sibar, o ku të duash ti". Pra muar maçen më dorë. Çeli manxhanastrin e u vu e luajti. Bëri di o tri xhire ndë mes të stanxjes.

U fermar ture rujtur më truall: “che senso ha tutto questo, che senso ha?”

Gjë fjuturoi llargu ka finestra, ka e cila dil ture mbjuar gjitoninë mùzik’e mangjanastrirt. Fjuturoi me pendat të gjera, ture kënduar, njera ket drita e llambjunit ket përpoqi ballët e ra e vdekur më truall.

Menatevet, kur Xhusepa me fshiesin mbjodhi kurmin e një kukuvije, ture e vënë ket kamjon’i spacaturës tha :”Firmozë ngë lën të rronj fare gjë. E vran edhe këtë”.

“Di lei non si è saputo più niente - më tha Mariuçi - sparita nel nulla...- e pra ture racionalizuar, sikur doni të burthonej se dij më shum se sa ish i zoti të thoi - come per un rifiuto della memoria, di un nome scolpito su una lapide... spariscono questi che spariscono come fossero stanchi di rispondere ad un appello... Pra se si profesor ç’ish shtoi: è come se non rispondessero alla *tentatione d’exister*.

Fatosi Garibaldin

Tatëmadhi im, Çezarini De Marko i Rraçapës, herë e herë, kur më vrenej të helmuar, vej ture më thën: Ti këtë çerë e vrëjtur e ke marr ka ati im Rrafelli i cili ish i njohur më shpì si “i vrëjturi”. Po ai kish ligjë t’ish i vrëjtur. Ty çë ke? Të hëngri bukën gadhuri? Ose bie e vërtetë se, si thuhet, ju Elmo e kini tek kazati fatin tuaj? E di ka vjen Elmo? ka shqipja Helm, Helmi, për këtë ju Elmo jini të helmuar.

Ish’e rronja ahirna një djaleri pa lumësi, për të ndryshme akunde, dashurije, skollje, e isha i papërshtatshëm e i paduruashëm për ngagjë, e pandefja se edhe stërtatëmadhi do të kish pasur, mund t’jetë, helmet tim. Po një ditë çë kisha ritratin e tij ndër duar, ndërsa vrenja atë fytyre serjoze e të rreptë, i lipa tatëmadh Çezarinit: Pse ati i strisate ish kështu i vrëjtur.

E tatëmadh Çezarini zu fill: Ati im Rrafelli çë kur ish i vogël batonej ket pëllas’i Damësravet, të cilët ishin t’urtë, karbunelë e mazunra. Gjegjënej fjalimet e tyre mbë Italinë e re, pa rregjëra e pa Papë, të cilët vaxhdojin e prisjin kryet o varjin o shkupetjasjin atà çë dojin lirin’ e mendimit e e ndërgegjes e edhe lirin’ e popujvet e sidomos republikën e demokracinë.

Gjegji te ai pëllas ëmërin e Mazzini-t e të Garibaldi-t. E u dhezë i magjepsur ka mësimet e tyrve, sidomos të Mazzini-t. Kështu kur kle hera, gjashtmbëdhjetvjeçar, u nisë si fjamurar me pesqindët ka Ugra çë doj’ të lirojin Italinë ka rregjërat ka Papa. Këndoj edhe ai “Addio mia bella addio” e “La bella Gigogin”, xu “Va pensiero” e gjithë këndimet ç’i ngrohjin zëmrin atyrve zëmërorë çë ëndërrjin “Lirin” me “Rivolucjonin” përposh mbrojtjen e Hyinivet Mazzini e Garibaldi,

Rrafelli, gjatë një luftim ndër malet e Bazilikatës, pat, pra, fatin e mir t’i shtringonej dorin Garibaldit e t’i kariconej kalin e bardhë. I marrë ka entusiasmi thërriti: “Generale, la repubblica. Viva Mazzini, viva la libertà, viva il popolo”. Gjenerali i çuditur i buzqeshi pa kujdhes, ndërsa cingërdhisnej kalin e spavej ndë mes të këmishavet të kuqe, sikur se do të fshehej i ngarë ka fjalët e atij trimi ç’i mbajin

mend një premëtim të kujit ngë kish si t'i mbanej benë. Një klllogjer frangjiskan ka Murana, ture e shtitur ndënjane, u nxitua t'i thoj: "A repubblica? Raffe', ura avimu autru a chi pinsa' "

Rrafelli luftoj me pesqindët ungrinjotra me zëmërim, sidomos mbë Volturnit e kur xu se rregji i Napulit kish ikur Gaetë, ngrëjti fjamurin me tri ngjyra ture thërritur: "Romë. Nani Romë, ungërnjotra, vem'e përzëmi Papën ka Roma, rroftë republika, rrofshin popujt të lirë".

Ngë pandefnej akoma se kush do revolucjonin është e gaton humbjen e vetëhesë së tij, pse shkuar revolucjona është i gatuar tash njetër pushtet, jo më i mir e jo më pak i egër e cinik se ai kundër të cilit ë e lufton. E xu kur Tean pa Garibaldin ç'i shtringonej dorin rregjit Vitor e e thërrit: Re d'Italia.

I ran të veshurat Rrafellit e i ra magjepsia e Garibaldit: e sesi një Itali pa rregjëra si thoj Mazzini? e ki Vitor kush është? Ng'është një rregj? Ç'është kjo lozje e Garibaldit? Do të shosh se do të gjëndemi pupani edhe përposh Papës?

Damësrat i spjeguan se nëng ndëlgonej "la politica e, soprattutto, le opportunità politiche". Ja spjeguan litish, edhe pse ata si gallandomëra ç'ishin, arbërishtjen pak e flisjin: "La politica ha le sue ragioni, che tu non puoi capire. Nel contesto internazionale la repubblica è solo un voto. Un voto del nostro magnanimo Maestro Mazzini. Ma solo un voto. Vorremmo finire sotto la brutale forza degli Chassepot francesi come già nel '49 sul fatal Gianicolo dove si spensero generose alme d'eroi? Non dobbiamo disperdere questo frutto del sangue dei martiri. Non muteranno e non scemeranno i vostri diritti. Ma la Storia ha i suoi tempi, e si dovrà pazientare. Io divino splendere il sole dell'avvenire. Presagisco che la Storia addiverrà alla libertà dei diseredati, alla libertà di culto, di pensiero; e secondo che divinò anche il profeta di Nazareth vivremo in spirito e verità. Il Gran Maestr,o dopo la gloriosa giornata ma infausta del Gianicolo e di Villa Panfili, conclusasi col tracollo della Repubblica, divisava molto opportunamente che il Verbo di Mazzini: "Italia, una e repubblicana" dovea mutarsi in Italia e Savoia. Ma se tu sei deluso dalle supreme e fatali ragioni della Storia che contraddicono ai nostri umili voti e ai voti espressi dal Verbo del nostro sublime Maestro che trovò effimera realizzazione nella fattispecie della gloriosa

Seconda Repubblica Romana, tornatene dai tuoi cari a Lungro. Ti saremo grati per il contributo dato alle magnifiche sorti della Patria nostra.”.

E ruajti me lipisi e si një atë shtoj, këtë herë arbërisht: Më mirë se, dita sot, ti prire Ungir.

E u pruar Ungir Rrafelli e nga dita, gjat vitrat e gjelles së tij, i vrëjtur, i pienej vetehesë ket mbrëndja e ndërgjegjes: “Çë na dha Vitori çë ngë kishim me Ferdinandrat e me Frangjiskrat? Populli është ngamon i vapëk e i ngratë. Gallandomërat jan te pëlleset më frymëdhenj se ngamon. Populli malpaton e është rop’i gallandomëravet si përposh Borbonëravet, përkundraz, me këtë diskursë e brigandravet, Vitori është e e na bën më të vdekur uri se mënjëhere...

Kur xu se një arbëresh si Krispi u kish bën “ipopodhi”, si thoj, ose skanieli, i këmbëvet i Lartësivet të tyre, Margarita e Umberti, e persekutonej punëtort, vu rrethë xerkut nje skolë, të zezë si të veshurat, sikur t’ish më lip e ngë desh të dinej më as Garibaldin, as mazunet, të cilëvet ai ish “il Gran Maestro”.

Vej ture thënë: Atdheu ynë e muar ndë llunjët më parë se të lefej. E njera sa është një çë kumandon, Liria, Populli, Demokracia, janë fjalë të sëmurta, të mira vet për ata çë mastrojin e farmakosjin popujt. E politika është mbledhja e intereseve të shemëtuamë mashkaratur jetërsimi.

Tatëmadh Çezarini përfundoj rrëfyemen e tij: Ti çë studhjon, çë thua, kishë o s’kishë ligjë stërtatmadhi it? E pe çë bën pra Savojrat, më parë, me të kotën Guerr’e Madhe, e pra me gallandomrat e fashizmit? Ndose kishin pasur sî, na kishin skriatur gjithëve me një guerrë sot e një menat. Ty bë si stërtatëmadhi, rri llargu ka politika e ka shteti, mir njerën e të tjetrën si motin e lig, si breshërin, si borën, si një monostrof. Mos ju shit mos njeriu, sidomos atyrve çë duan të të magjepsjin me fjalë të mëdhà e të sëmurta e të kota, si thoj ati im, i vrëjturi. Ndose mundin, bë mirë e harrò. Rro i fshefur, llargu ka gjithë, ture shkaptuar ngamon ka shumicat e farmakosura ka propaganda të njerit e të tjetrit. Gjegj vet ndërgjegjen tënde. E

shkaptò ka ndonjë pozicjon e sterët, sidomos ndose ka të sterksurit e shumicës.

Nando ELMO (arbërisht: Nandin'i Helmëravet) lindi Firmozë (Acquaformosa, CS, Italy) në 03- 11 – 38. Është skrimëtar, poet, eseist litishtë e arbrishtë dhe piktor i njohur. Bëri studimet te Universiteti “La Sapienza” Romë edhe Palerm tek u diplomar në literasi modherne. Te Univesitet’i Torino u ekspertizua në “Gjuhësi e përgjithëshme e Semjologjië”. Gjellon e vepron në Rivarolo Canavese te krahina e Torino. Është i cituar si i rëndësishëm intelektual arbëresh te libr’i Demetrio-t Emmanuele “**Arberia**”.